

KRIJIMI I PARANDALIMIT MULTI-PROFESIONAL TË DHUNËS ME BAZË
GJINORE, PUNËS ME DHUNUESIT TË ORIENTUAR DREJT SIGURISË SË
VIKTIMAVE DHE KËSHILLIMIN E BURRAVE NË MAQEDONINË E VERIUT

RAPORTI I STATUS QUO-SË MBI DHUNËN ME
BAZË GJINORE, KORNIZA LIGJORE DHE
REAGIMI INSTITUCIONAL
DHE

ANALIZA E NEVOJAVE DHE BURIMEVE MBI
PUNËN E ORIENTUAR DREJT SIGURISË SË
VIKTIMAVE ME DHUNUESIT DHE KËSHILLIMIN
E BURRAVE

(Versioni përfundimtar)

Shkup, 2023





RAPORTI I STATUS QUO-SË MBI DHUNËN ME BAZË GJINORE, KORNIZA LIGJORE DHE REAGIMI INSTITUCIONAL DHE ANALIZA E NEVOJAVE DHE BURIMEVE MBI PUNËN E ORIENTUAR DREJT SIGURISË SË VIKTIMAVE ME DHUNUESIT DHE KËSHILLIMIN E BURRAVE (Versioni përfundimtar), KRIJIMI I PARANDALIMIT MULTI-PROFESIONAL TË DHUNËS ME BAZË GJINORE, PUNËS ME DHUNUESIT TË ORIENTUAR DREJT SIGURISË SË VIKTIMAVE DHE KËSHILLIMIN E BURRAVE NË MAQEDONINË E VERIUT.

Titulli i origjinalit:

STATUS QUO REPORT ON GENDER-BASED VIOLENCE, LEGAL FRAMEWORK AND INSTITUTIONAL RESPONSE AND NEEDS AND RESOURCES ANALYSIS ON VICTIM-SAFETY ORIENTED WORK WITH PERPETRATORS AND MEN'S COUNSELLING (Final Report), ESTABLISHMENT OF MULTI-PROFESSIONAL PREVENTION OF GENDER-BASED VIOLENCE, VICTIM-SAFETY ORIENTED WORK WITH PERPETRATORS AND MEN'S COUNSELLING IN NORTH MACEDONIA.

Botuesi:

Reaktor - Hulumtim në veprim

Për botuesin:

Tanja Ivanova

Redaktor:

Tanja Ivanova

Autorët:

Tanja Ivanova, Vaska Leshoska, Irina Jolevska

Përkthim nga gjuha angleze:

Lindita Abdullahu

Mostër falas/jokomerciale

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје; 364.63-055.2:340.13(497.7)(047.31); 364.4-055.1:364.63-055.2(497.7)(047.31); IVANOVA, Tanja

Raporti i status quo-së mbi dhunën me bazë gjinore, korniza ligjore dhe reagimi institucional dhe analiza e nevojave dhe burimeve mbi punën e orientuar drejt sigurisë së viktimave me dhunuesit dhe këshillimin e burrave [Електронски извор] : (versioni përfundimtar) : krijimi i parandalimit multi-profesional të dhunës me bazë gjinore, punës me dhunuesit të orientuar drejt sigurisë së viktimave dhe këshillimin e burrave në Maqedoninë e Veriut / [autorët Tanja Ivanova, Vaska Leshoska, Irina Jolevska ; përkthim nga gjuha angleze Lindita Abdullahu]. - Shkup : Reaktor - Hulumtim në veprim, 2023 Начин на пристапување (URL): <https://reactor.org.mk/en/publication-all/raporti-i-status-quo-se-mbi-dhunen-me-baze-gjinore-korniza-ligjore-dhe-reagim-institucional-dhe-analiza-e-nevojave-dhe-burimeve-mbi-punen-e-orientuar-drejt-sigurise-se-viktimave-me-dhunuesit-dhe-kes/>.

- Превод на делото: Status quo report on gender-based violence, legal framework and institutional response and needs and resources analysis on victim-safety oriented work with perpetrators and men's counselling : (final report) : establishment of multi-professional prevention of gender-based violence, victim-safety oriented work with perpetrators and men's counselling in North Macedonia. - Текст во PDF формат, содржи 70 стр., илустр. - Фусноти кон текстот. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 15.03.2023

ISBN 978-608-4684-48-0

PËRMBAJTJA

Hyrje	6
Pasqyrë e shkurtër e qasjes hulumtuese	7
Kapitulli 1	9
Dhuna me bazë gjinore	9
Prevalenca dhe raportimi	9
Pabarazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore	13
Pabarazia gjinore dhe maskuliniteti normativ	17
Kapitulli 2	25
Korniza ligjore dhe përgjigja institucionale	25
Standardet ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.....	25
Standardet kombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore	27
Shërbime për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare	29
Shërbimet për trajtimin psiko-social të dhunuesve.....	30
Bazat për t'u përfshirë në një trajtim për kryerësit e dhunës në familje	32
Zbatimi i masës së përkohshme për trajtimin e dhunuesve	36
Programet e trajtimit për kryerësit e dhunës seksuale.....	38
Masa të tjera parandaluese	40
Të dhëna administrative për dhunën në familje	43
MPPS - Ministria për Punë dhe Politikë Sociale.....	44
Ministria për Punë të Brendshme	46
Gjykatat dhe prokurORët publik	49
Kapitulli 3	53
Hartimi i nevojave dhe burimeve - anketë me palët e interesit	53
Qëndrimet ndaj barazisë gjinore dhe këshillimin e dhunuesve.....	54
Trajnime për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.....	58
Mobilizimi për parandalim të DhBGj	60
Shërbime të specializuara për kryerësit e DhBGj.....	62
Shërbime të specializuara për viktimat DhBGj.....	65
Përfundime dhe rekomandime	68

SHKURTESA

BE	Bashkimi Evropian
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
LPMDhFDhF	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje
PSO	Procedurat Standarde Operative
QPS	Qendra për Punë Sociale

HYRJE

Si pjesë e projektit "Krijimi i parandalimit multi-profesional të dhunës me bazë gjinore, punës me dhunuesit të orientuar drejt sigurisë së viktimave dhe këshillimin e burrave në Maqedoninë e Veriut"¹, zhvilluam një analizë gjithëpërfshirëse të situatës dhe nevojës për qendra të këshillimit të burrave në Maqedoninë e Veriut, me fokus në dhunën me bazë gjinore.

Ky dokument përfshin gjetjet kryesore nga analiza dhe studimi hulumtues në internet i kryer për të lehtësuar zhvillimin e konceptit dhe planeve kombëtare për krijimin e parandalimit parësor efektiv kundër dhunës me bazë gjinore, mbështetjen multi-profesionale dhe punën me dhunuesit përmes qasjes së orientuar drejt sigurisë së viktimave dhe krijimin e qendrave për mbështetje dhe këshillim gjithëpërfshirës të burrave për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, inkurajimin e barazisë gjinore dhe përfshirjen e burrave në kujdes (prindërim, partneritet, etj.) në Maqedoninë e Veriut. Kapitujt e parë përqendrohen në situatën aktuale me dhunën me bazë gjinore në vend dhe përkufizimet ekzistuese përkatëse dhe kornizën ligjore, duke eksploruar të dhënat ekzistuese dytësore mbi prevalencën dhe dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën intime të partnerëve, të dhënat e disponueshme administrative nga institucionet përkatëse dhe raportet nga hulumtimet dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe parandalimin parësor dhe dytësor të dhunës, me një fokus të veçantë në punën me burrat. Kapitulli i fundit përfshin gjetjet kryesore të hulumtimit dhe hulumton nevojat dhe burimet nga pikëpamja e palëve përkatëse të interesit.

1 Projekti "Krijimi i parandalimit multi-profesional të dhunës me bazë gjinore, punës me dhunuesit të orientuar drejt sigurisë së viktimave dhe këshillimin e burrave në Maqedoninë e Veriut" (2021-2022) është një projekt afatshkurtër i financuar nga ministria federale e austrisë për çështjet sociale, shëndetësinë, kujdesin dhe mbrojtjen e konsumatorit, porositur nga organizata partnere *verein für männer- und geschlechterthemen steiermark* (vmg)/institut für männer- und geschlechterforschung, austri, dhe zbatuar nga *reactor – hulumtim në veprim dhe hera nga Maqedonia e Veriut*.

PASQYRË E SHKURTËR E QASJES HULUMTUESE

Me qëllim të eksplorimit të status quo-së lidhur me dhunën me bazë gjinore dhe punën me dhunuesit të orientuar drejt sigurisë së viktimave, u përdorën si relevante si metodat dytësore ashtu edhe ato primare të mbledhjes së të dhënave për të gjithë kapitujt tematikë të raportit. Informacioni i përgjithshëm u përditësua përsëri pas përfundimit të fazave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave që u zhvilluan midis tetorit 2021 dhe majit 2022.

Qasja kërkimore u përqendrua rreth pikave të mëposhtme:

- ✓ Rishikimi i literaturës ekzistuese dhe analizat e të dhënave dytësore
- ✓ Mbledhja e të dhënave administrative përmes Kërkesave në bazë të Lirisë për Informim dërguar institucioneve përkatëse kombëtare dhe ofruesve të shërbimeve
- ✓ Diskutime cilësore dhe intervista për të informuar dizajnimin e instrumentit anketues në internet dhe strukturën e raportimit
- ✓ Dizajnimi i instrumenteve anketuese në internet, struktura e mostrës dhe anketa e hartëzimit në internet me palët e interesuara

Krahas shqyrtimit dytësor të të dhënave, Kërkesat në bazë të Lirisë së informimit iu dërguan Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, strehimoreve të grave si dhe gjykatave dhe prokurorëve publikë, për të mbledhur të dhëna administrative të qasshme dhe të disponueshme për dhunën me bazë gjinore dhe përgjigjen institucionale. Përgjigjet zyrtare të pranuar nga institucionet janë regjistruar dhe analizuar në bazë të rëndësisë së tyre tematike.²

Përveç kësaj, u zhvillua një instrument anketues në internet bazuar në njohuritë nga konsultimet dhe diskutimet e ekspertëve me përfaqësues të institucioneve përkatëse, organizatave të shoqërisë civile dhe profesionistëve të tjerë (psikoterapistë etj.). Mostra e palëve të interesit për anketën në internet u dizajnuar në bazë të një kornize të kampionit të përpiluar pas intervistave kryesore të ekspertëve. Për mbledhjen e të dhënave si platformë për të nisur anketën u përdor Lime Survey dhe serveri i Reaktor-it në përputhje me Rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave dhe legjislacionin lidhur me privatësinë e të dhënave në vend. Të dhënat primare u mbledhën me pyetje të mbyllura të anketës, të cilat u analizuan duke përdorur softuerin statistikor SPSS. Analiza statistikore jep përshkrime të shtrirjes së përgjigjeve të vëzhguara, të cilat më tej sqarohen nga një analizë cilësore. Rezultatet e anketës në

² Ligjërisht, institucionet kombëtare kanë 20 ditë për t'iu përgjigjur Kërkesave për Lirin e informimit, por disa kërkesa zgjatën shumë më shumë se sa ishte e parashikuar dhe ndërsa mbledhja e të dhënave administrative zakonisht zgjat më shumë se sa është e nevojshme, ky proces u bë edhe më sfidues për shkak të natyrës së informacionit të kërkuar. I gjithë procesi filloi në dhjetor 2021 dhe përfundoi rreth marsit dhe prillit 2022.

internet dhe eksplorimet cilësore u përqendruan në hartimin dhe sistematizimin e nevojave në krijimin e parandalimit multi-profesional të dhunës me bazë gjinore, punën me dhunuesit të orientuar drejt sigurisë së viktimave dhe këshillimin e burrave në Maqedoninë e Veriut.

Paralelisht me proceset për mbledhjen e të dhënave, ekspertët ligjorë vlerësuan kornizën aktuale ligjore dhe përgjigjen institucionale për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës me bazë gjinore, me fokus tek burrat. Krahas analizës së kornizës ligjore kombëtare, u morën në konsideratë edhe instrumentet dhe standardet e ratifikuara ndërkombëtare dhe në kontekstin e reagimit të përgjithshëm institucional në drejtim të parandalimit dhe sanksionimit të dhunës me bazë gjinore, u hulumtua gjithashtu edhe disponueshmëria e mekanizmave mbështetës për të mbijetuarit nga dhuna me bazë gjinore dhe risocializimi i dhunuesve.

KAPITULLI 1

DHUNA ME BAZË GJINORE

PREVALENCA DHE RAPORTIMI

Dhuna me bazë gjinore vazhdon të jetë një nga shkeljet më të dukshme të të drejtave të njeriut në të gjitha shoqëritë. Dhuna me bazë gjinore është dhunë e drejtuar kundër një personi për shkak të gjinisë së tyre dhe përderisa si gratë ashtu edhe burrat përjetojnë dhunë me bazë gjinore shumica e viktimave janë gra dhe vajza. Andaj, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave janë terma që shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, pasi është pranuar gjerësisht se shumica e dhunës me bazë gjinore shkaktohet mbi gratë dhe vajzat, nga ana e burrave³. Megjithatë, përdorimi i aspektit 'me bazë gjinore' është i rëndësishëm pasi thekson faktin se shumë forma të dhunës kundër grave janë të rrënjosura në pabarazitë e pushtetit midis grave dhe burrave. Dhuna me bazë gjinore është një manifestim i shpërndarjes historikisht të pabarabartë të pushtetit midis grave dhe burrave, duke çuar në diskriminim më të shpeshtë ndaj grave dhe duke parandaluar gratë që të bëjnë përparim më të mirë në të gjitha fushat e jetës së tyre.

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave janë një shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe pengesa më e madhe për arritjen e barazisë gjinore.⁴ Sipas vlerësimeve të OBSH-së, rreth një e treta (30%) e grave në nivel global kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale në marrëdhëniet intime ose dhunë seksuale jo me partnerë në një moment të jetës së tyre.⁵ Dhuna ndaj grave kryhet më shpesh nga partnerët aktualë ose ata të mëparshëm intimë, ndërsa sipas vlerësimeve të OKB-së mesatarisht, çdo 11 minuta vritet një grua ose vajzë nga ana e dikujt në familjen e saj.⁶ Përvoja e dhunës fillon herët dhe pothuajse një në katër vajza adoleshente të moshës 15–19 vjeç (24%) që kanë qenë në një marrëdhënie kanë përjetuar sulme fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim.

3 Dhuna ndaj grave: anketë në mbarë BE-në. Raporti i rezultateve kryesore, 2014. Në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>

4 Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën ndaj Grave, 1993

5 Organizata Botërore e Shëndetësisë, në emër të Grupit punues ndërinstitucional të Kombeve të Bashkuara për Vlerësimin e dhunës ndaj grave dhe të dhënave (2021). Vlerësimet e prevalencës së dhunës ndaj grave, 2018. Vlerësimet e prevalencës globale, rajonale dhe kombëtare për dhunën nga partneri intim ndaj grave dhe vlerësimet e prevalencës globale dhe rajonale për dhunën seksuale nga jo partnerët kundër grave.

6 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (2021) Vrasjet e grave dhe vajzave nga partneri i tyre intim ose anëtarë të tjerë të familjes Vlerësimet globale 2020.




Figura 1. Prevalenca e dhunës ndaj grave në Maqedoninë e Veriut⁷

Sipas sondazhit të udhëhequr nga OSBE dhe të financuar nga BE “Siguria dhe mirëqenia e grave”⁸, bazuar në një mostër kombëtare të përfaqësimit, më shumë se gjysma ose **54% e grave në Maqedoninë e Veriut kishin përjetuar një formë të dhunës gjatë jetës së tyre**. Pothuajse një në tre ishte ngacmuar seksualisht (30%), 14% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale dhe një në dhjetë kishte përjetuar përndjekje (7%). Përvoja më e shpeshtë e përjetuar është dhuna psikologjike nga partneri intim me 44% të grave që vuajnë këtë lloj dhune.

Përhapja e dhunës e zbuluar në sondazh është krahasimisht më e ulët se në të gjithë BE-në, por kjo mund t’i atribuohet qëndrimeve që normalizojnë dhunën⁹. Për shembull, pothuajse gjysma (48%) e grave në Maqedoninë e Veriut pajtohen se dhuna është një çështje private që duhet të trajtohet brenda familjes

7 Të dhënat nga sondazhi i udhëhequr nga OSBE “Siguria dhe mirëqenia e grave” i kryer në vitin 2018 dhe i publikuar në vitin 2019. Bazuar në metodologjinë e anketimit të FRA, të kryer në BE në vitin 2014, sondazhi u krye në Evropën Juglindore ose Evropën Lindore për të siguruar të dhëna të krahasueshme në të gjithë rajonin. Kjo është anketa e parë dhe e vetme përfaqësuese në nivel kombëtar për DhBGJ në MV. Mbulon të gjitha format e dhunës përmes moduleve të ndryshme (duke përfshirë përvojat që kanë të bëjnë me konfliktin) dhe shqyrton përvojat e dhunës në mesin e një mostre përfaqësuese të gjerë shtetërore të 1910 grave të moshës 18-74 vjeç, duke përfshirë 496 gra të përkatësisë etnike shqiptare. Ajo u bazua në një dizajn të mostrës së probabilitetit me shumë faza, të shtresuar dhe të rastësishëm. Raporti i plotë këtu: https://www.osce.org/files/f/documents/3/5/419264_1.pdf

8 Ibid.

9 Zbulimi i dhunës së përjetuar është më i lartë në vendet me traditë më të gjatë të politikave të barazisë gjinore. Sipas sondazhit të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) të kryer në të gjithë BE-në, tre shtetet ku gratë kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale në duart e një partneri ose një jo-partneri që nga mosha 15 vjeçare ishin Danimarka (52%), Finlanda (47%) dhe Suedia (47%).

dhe kjo shkallë është tre herë më e lartë në krahasim me BE-në. Për më tepër, gati një e treta (30%) e grave pajtohen se gratë që thonë se janë abuzuar shpesh shpifin ose ekzagjerojnë pretendimet për abuzim ose përdhunim. Megjithatë, më shumë se **gjysma e grave në vend (60%) mendojnë se dhuna ndaj grave është një fenomen i zakonshëm ndërsa pothuajse tre në dhjetë gra mendojnë se kjo ndodh shpesh**¹⁰.

Dhuna e përjetuar ka ndikim të rëndë fizik dhe psikologjik tek gratë. Përgjigjet më të zakonshme emocionale janë frika, zemërimi, bezdia dhe turpi, ndërsa pasojat afatgjata psikologjike përfshijnë ndjenjat e lëndueshmërisë, problemeve të gjumit dhe depresionit.¹¹

Sa i përket faktorëve të rrezikut, gratë që kanë përjetuar dhunë në fëmijërinë e tyre kanë shumë më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunën si të rritura sipas të dhënave të sondazhit. Për më tepër, përvojat e dhunës fizike dhe seksuale nga ana e partnerëve intimë ishin më të përhapura në mesin e grave që ishin ekonomikisht të varura dhe jetonin në familje të privuara socio-ekonomike (17% e atyre që e kishin shumë të vështirë të përballonin me të ardhurat e tyre kundrejt 9% mesatarisht). Nga ana tjetër, ngacmimi seksual më shpesh është zbuluar nga gratë më të reja, ato që jetonin në zonat urbane dhe ato me arsim të lartë, megjithatë prevalenca më e lartë midis këtyre kategorive të grave mund të sugjeronte gjithashtu një tolerancë më të ulët ndaj ngacmimit seksual midis tyre.

Kur merren parasysh karakteristikat e dhunuesve¹², gratë, partnerët e të cilave pinin alkool çdo javë ose çdo ditë, kishin më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunë nga partneri intim. Faktorë të tjerë rreziku që lidhen me dhunuesit përfshijnë papunësinë dhe përvojën në konflikt të armatosur. Për më tepër, gratë ishin më të prirura për të zbuluar dhunën e pësuar nga partneri i mëparshëm sesa ai aktual, por turpi dhe frika e pasojave nga partneri aktual mund të kontribuojnë për këtë mospërputhje¹³.

Sa i përket raportimit të dhunës tek institucionet kompetente, gratë që kishin përjetuar dhunë nga jo partnerët ose ish-partnerët kishin më shumë gjasa të raportnin incidentin e tyre më të rëndë në polici ose institucion tjetër në krahasim me ato që i ishin nënshtruar dhunës në duart e partnerit të tyre aktual. Megjithatë, duhet të theksohet se shumica e viktimave nuk raportojnë dhunë. **Gati nëntë në dhjetë gra që kanë pësuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i tyre aktual nuk e kanë raportuar atë në asnjë institucion kompetent ose organizatë ofruese të shërbimit ndërsa vetëm 2% kanë raportuar atë që ato kanë konsideruar si incidentin më serioz të dhunës në polici.** Ndër ato që kanë pësuar

10 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, 2019.

11 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, 2019.

12 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor, 2019; në dispozicion në: https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/413237_0.pdf

13 Ky supozim nuk është hulumtuar në anketën e cituar për shkak të nën mostrave më të vogla dhe prevalencës së ulët të vlerësuar për raportim të dhunës me bazë gjinore.

dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri aktual, një në pesë e kanë raportuar atë në polici, ndërsa shkalla e raportimit është një në katër për dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo partnerë. Krahas normave shoqërore mbizotëruese që normalizojnë dhunën dhe stigmatizojnë viktimat, sipas sondazhit të udhëhequr nga OSBE, shumica e grave nuk dinë se çfarë të bëjnë nëse janë viktimat të dhunës dhe nuk janë në dijeni të shërbimeve të specializuara lokale që mund t'i ndihmojnë ato.

PABARAZIA GJINORE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE

Dhuna me bazë gjinore nuk ndodh në një vakum. Pabarazitë socio-ekonomike krijojnë dhe mbështesin asimetrinë e pushtetit që buron nga rolet tradicionale gjinore, duke përjetësuar dhunën me bazë gjinore.

Maqedonia e Veriut përballlet me boshllëqe gjinore të vazhdueshme dhe të rrënjosura thellë në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Në vendimmarrje, gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar si në pushtetin në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal.




Figura 2. Përqindja e grave dhe burrave në pozicionet politike vendimmarrëse.

Burimi: Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), Baza e të dhënave për statistikat gjinore.

Që nga themelimi i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, asnjë grua nuk është zgjedhur si kryetare e shtetit dhe vetëm një grua është emëruar si kryetare e Qeverisë, por vetëm si kryeministre në detyrë për gjithsej 50 ditë, në vitin 2014. Në mënyrë kumulative, vetëm 12% e të gjithë ministrave të emëruar kanë qenë gra (të dhëna nga viti 2008 deri në vitin 2021, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet dhe rikonstruksionet). Në nivel lokal, vetëm 3% nga të gjithë kryetarët e komunave të zgjedhur ishin gra (të dhëna nga 1996 deri në 2022). Gjatë viteve, përfaqësimi ka qenë krahasueshëm më i mirë, por ende larg të qenit i barabartë në parlamentin kombëtar dhe këshillat vendorë, ndërsa përmirësimet janë vetëm si shkak i kuotave të imponuara me ligj për Parlamentin.

Përfaqësimi i ultë në pozitat vendimmarrëse është gjithashtu i dukshëm edhe në sferën ekonomike. Vetëm 29% e kompanive kanë gra që janë pronare të pjesërishtme¹⁴ ndërsa vetëm 21% kanë gra në pozita të larta drejtuese¹⁵. Është intriguese, këto boshllëqe në përfaqësimin në pozicionet vendimmarrëse (si politike ashtu edhe ekonomike) nuk mund të shpjegohen ose të ndërlidhen me përparimin arsimor pasi, gjatë viteve, gratë shfaqin një shkallë më të lartë të arritjes në arsim të lartë.¹⁶

Pabarazitë gjinore janë të dukshme edhe në qasjen në burimet financiare gjithashtu. Besimet tradicionale që ua përshkruajnë të drejtat e trashëgimisë pasardhësve meshkuj mund të ndikojnë në faktin se gratë kanë shumë më pak gjasa të zotërojnë tokë ose pasuri të patundshme. Sipas të dhënave administrative të Kadastrës kombëtare, vetëm 27% e grave janë pronare të tokave. Ky disavantazh është veçanërisht i dëmshëm për gratë nga zonat rurale duke pasur parasysh se toka shpesh është pasuria më e rëndësishme familjare për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe sigurimin e fuqizimit ekonomik. Duke mos pasur pronësinë (e sigurt) të tokës, gratë nga zonat rurale kanë më pak fuqi negociuese në amvisëritë e tyre dhe kështu mund të jenë më të cënueshme ndaj dhunës ekonomike. Kjo mbështetet më tej nga statistikat zyrtare që tregojnë se shumica e punëtorëve të papaguar të familjes janë gra.

Asimetritë e pushtetit mund të vëzhgohen më tej në këndvështrimet e lëvizshmërisë. Për të ushtruar të drejtën e tyre për punë, arsim, kohë të lirë ose për të përmbushur nevoja të tjera, gratë shpesh varen nga transporti publik ose nga të tjerë të (anëtarë të familjes) që kanë një veturë. Vetëm 18% e automjeteve private janë në pronësi të grave, sipas të dhënave administrative nga Ministria e Punëve të Brendshme. Pabarazitë në mundësitë për lëvizshmëri përkeqësohen më tej nga fakti se Maqedonia e Veriut ka një transport publik të pazhvilluar dhe kjo çështje ishte veçanërisht e zymtë gjatë pandemisë me KOVID-19 kur ishin të vendosura kufizime. Përballë dhunës dhe konfliktit, kjo varësi lëvizshmërie shteron më tej mundësitë e grave për të vepruar në rast emergjence ose për të lënë dhunuesin. Për më tepër, transporti

14 Banka Botërore, Sondazhet e Ndërmarrjeve, të dhëna për vitin 2019. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/indicator/IC.FRM.FEMO.ZS?vendndodhje=MK>

15 Banka Botërore, Sondazhet e Ndërmarrjeve, të dhëna për vitin 2019. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/indicator/IC.FRM.FEMM.ZS?vendndodhje=MK>

16 Eurostat (të dhënat nga viti 2006 deri në vitin 2020) Anketa Evropiane e Fuqisë Punëtore.

publik nuk është gjithmonë “opsioni më i sigurt” për gratë ndërsa studimet kanë treguar se gratë kanë më shumë gjasa të përballen me dhunën me bazë gjinore dhe ngacmimin seksual në hapësirat publike.¹⁷

Për sa i përket pabarazive ekonomike, boshllëqet gjinore në punën e paguar janë gjithashtu një faktor i rëndësishëm dhe ato më tej ilustrojnë pabarazitë gjinore. Sipas statistikave zyrtare, 45.3% e grave në moshë pune janë të punësuar, krahasuar me 63.7% të burrave¹⁸. Megjithëse shkallët e punësimit janë rritur me kalimin e kohës si për burrat ashtu dhe për gratë, hendeku gjinor ka vazhduar dhe mbetet gati dy herë më i madh në krahasim me mesataren e Bashkimit Evropian të vitit 2020 (MV=18.4 p.p. kundrejt BE-27=10.3 p.p.).

Shkallët e punësimit (nga 15 deri në 64 vjet)




Figura 3. Shkalla e punësimit të grave dhe burrave në Maqedoninë e Veriut dhe Bashkimin Evropian (BE-27) nga viti 2011 deri në vitin 2020.

Burimi: eurostat, Anketa e fuqisë punëtore evropiane.

17 Reaktor-Hulumtim në Veprim (2020). Dhuna me bazë gjinore në hapësirat publike në Shkup. Në dispozicion në: <https://reactor.org.mk/en/wp-content/uploads/sites/4/2020/11/Reaktor-Scoping-Study-ANG-web.pdf>

18 Eurostat (Përditësimi i fundit: 10-09-2021). Normat e punësimit sipas gjinisë, moshës dhe nivelit të arritjes arsimore (%), të zgjedhuraviti 2020, grupmosha 15 deri në 64 vjeç. Në dispozicion në: <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/setupDownloads.do>.

Pabarazia në shkallët e punësimit midis burrave dhe grave rurale ka mbetur edhe më e madhe (24 pikë përqindje)¹⁹, duke nënkuptuar barriera shumë shtresore për disa gra dhe diskriminim të mundshëm ndërsektorial. Hendeku gjinor rritet më tej midis prindërve me fëmijë të vegjël - nga 14,4 p.p. tek ata pa fëmijë në 32,4 p.p. midis atyre me fëmijë më të vegjël se gjashtë vjeç (të dhënat nga 2020).²⁰

Për më tepër, gati gjysma e grave në moshë pune konsiderohen si ekonomikisht joaktive ose jashtë fuqisë punëtore, pasi ato nuk janë të regjistruara si punëkërkuese aktive²¹. Arsytet kryesore të pasivitetit për më shumë se gjysmën e këtyre grave (59%) janë përgjegjësitë që lidhen me kujdesin për fëmijët ose përgjegjësitë e tjera të kujdesit, ndërsa kjo tregohet si arsyeja kryesore nga vetëm 2% e burrave në të njëjtën kategori.

Shkallët e aktivitetit (nga 15 deri në 64 vjeç)




Figura 4. Shkalla e punësimit të grave dhe burrave në Maqedoninë e Veriut dhe Bashkimin Evropian (BE-27) nga viti 2011 deri në vitin 2020.

Burimi: Eurostat, Anketa evropiane e fuqisë punëtore.

19 Eurostat (Përditësimi i fundit: 10-09-2021 23:00). Shkalla e punësimit sipas gjinisë, moshës dhe shkallës së urbanizimit (%). Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/LFST_R_ERGAU_custom_1301016/default/table?lang=en

20 Eurostat (Përditësimi i fundit: 02-06-2021). Shkalla e punësimit të të rriturve sipas gjinisë, grupmoshave, arritjeve arsimore niveli, numri i fëmijëve dhe moshës së fëmijës më të vogël (%). Në dispozicion në: <http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

21 Eurostat (Përditësimi i fundit: 10-09-2021 23:00). Shkalla e aktivitetit sipas gjinisë, moshës dhe shtetësisë (%), viti i zgjedhur 2020, grupmosha 15 deri në 64 vjet. Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/LFSA_ARGAN_custom_1300916/default/table?lang=en.

Statistikat e mësipërme tregojnë se më shumë se gjysma e grave në moshë pune nuk kanë kurrfarë të ardhurash nga punësimi i paguar. Kjo do të thotë se më shumë se gjysma e grave në moshë pune në vendin tonë janë ekonomikisht të varura dhe mund të jenë në rrezik të dhunës dhe abuzimit ekonomik. Duke mos pasur të ardhura të tyre, në rast të ndonjë dhune në familje, ato mund të privohen nga burimet financiare nëse largohen nga cikli i dhunës. Këto perspektiva janë edhe më të tmerrshme përballë mekanizmave për mbrojtje sociale që janë në dispozicion. Sipas Ligjit për mbrojtje sociale²², viktimat e dhunës në familje mund të marrë deri në 15.000 denarë si pagesë të njëhershme për mbrojtje urgjente dhe strehim dhe deri në 12.000 denarë për kujdes shëndetësor dhe trajtim mjekësor për një person-viktimë të dhunës në familje. Ndihma e njëhershme financiare e miratuar është më e vogël se paga minimale dhe është diskutabile nëse mund të trajtohet si e mjaftueshme. Për më tepër, viktimat e dhunës me bazë gjinore kanë të drejtën ligjore për një ndihme minimale të garantuar si ndihmë financiare, por realizimi i kësaj të drejte varet nga vërtetimi se kanë pësuar nga dhuna në familje. Si rezultat, kjo formë e mbrojtjes sociale nuk siguron ndihmën fillestare financiare të kërkuar nga një viktimë për të vendosur të largohet nga një marrëdhënie abuzive²³. Përveç ndihmës së pamjaftueshme financiare, sistemi i mbrojtjes sociale parashikon strehim të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje ose me bazë gjinore me strehim deri në tre muaj (në rrethana të jashtëzakonshme deri në 6 muaj, por jo më shumë se një vit), por shumë gra janë praktikisht të privuara nga ushtrimi i kësaj të drejte për shkak të mungesës së qendrave të strehimit të krijuara siç duhet. Sipas Ligjit të ri për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, masa për strehim të përkohshëm përfshin ndër të tjera integrimin e grave viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në masat aktive për punësim. Mbetet e hapur nëse kjo do të avancojë më tej sistemin për mbrojtjen e grave-viktima të dhunës me bazë gjinore, duke pasur parasysh bashkëpunimin e ulët institucional. Për ilustrim, në vitin 2019, vetëm 78 viktimat të dhunës me bazë gjinore janë referuar në Agjencinë për Punësim, që është 7% e numrit të përgjithshëm të grave që kanë raportuar se kanë qenë viktimat të dhunës në familje po në të njëjtin vit²⁴.

PABARAZIA GJINORE DHE MASKULINITETI NORMATIV

Pritjet dhe praktikat shoqërore të ndërtuara mbi ideologji të caktuara në mënyrë të nënkuptuar ose të qartë formojnë identitetet, sjelljet dhe përvojat e njerëzve. Identitetet gjinore dhe praktikat gjinore janë pjesë e këtij procesi, si dhe ndërtimi i seksualiteteve dhe besimeve (normative) të asaj çfarë është sjellje “e mirë” dhe aspiruese. Kështu, burrat dhe gratë kanë prirje për t’u përshtatur me praktika të caktuara në mënyrë që të përmbushin pritjet shoqërore që ndërtojnë identitetet e tyre gjinore. Megjithatë maskuliniteti

22 Ligji për Mbrojtjen Sociale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21 dhe 99/22.

23 Rrjeti kombëtar për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – “Zëri kundër dhunës” (2019). Aspekti gjinor dhe Viktimat e dhunës në bazë gjinore dhe familjare në Ligjin për mbrojtje sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

24 Nushkova, A., Balshiçevska, M. (2020). Rekomandime për avancimin e mundësive të punësimit për gratë viktimat të dhunës në familje. Rrjeti kombëtar për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – “Zëri kundër dhunës”.

normativ nuk është praktika më e zakonshme e burrave dhe ndryshimeve brenda kontekstit, është ajo që shoqëria pret të miratojnë burrat. Narativat për maskulinitetin dominues ose hegjemonik janë mishëruar në përfaqësimet kulturore të burrave të fortë dhe të fuqishëm që janë superiorë ndaj të tjerëve. Raewyn Connell e përkufizon maskulinitetin hegjemonik duke u mbështetur në kuptimin e hegjemonisë të Gramsci-t si praktika të sundimit jo nga forma e tiranisë, por nga pajtimi (i pavetëdjishëm).²⁵

Megjithëse ndryshojnë përkufizimet bashkëkohore, maskulinitetet hegjemonike shpesh ndërtohen mbi ide të caktuara të lidhura me pushtetin, siç janë pritshmëritë që burrat të kenë rolin e kujdesësit të familjes, ose nocioni i burrave si ndërmarrës të rrezikut, ose burrave si sipërmarrës, ose burrave si 'vendimmarrës', ose burrave si 'gjinia më e fortë', dmth stereotipat e pranuar shoqërore për rolet gjinore. Ndërsa nocioni "sillu si burrë" përqendrohet tek burrat, ai paraqet një barrë si për gratë ashtu edhe për burrat, njësoj si për shumë norma të tjera që rrjedhin nga praktikat dhe ideologjitë e tilla. Analizat e fundit tregojnë se burrat shprehin ankth, depresion dhe frustrim në pamundësinë e përbushjes së këtyre roleve në ekonomitë moderne²⁶ dhe tranzicionale dhe nëse nuk adresohen siç duhet këto ankthe, në një rreth vicioz, ato shpesh bien edhe në kurriz të grave.

Dështimet për të përbushur rolin e pritur të 'burrit' si furnizues ose 'gjinia më e fortë' dhuna e mëtejshme dhe dhuna si pohim i dominimit dhe asimetrive të pushtetit shpesh përdoret si demonstrim dhe riprodhim i maskulinitetit hegjemonik dhe guximin për t'u përballur ose për të nxitur situata të rrezikshme dhe konfliktuale²⁷. Prandaj, kryerësit e veprave penale janë më shpesh burrat ndërsa burrat gjithashtu janë shumica e kryerësve të krimeve të dhunshme siç janë krimet kundër jetës dhe trupit dhe krimet kundër lirisë seksuale (të cilat gjithashtu i konfirmon kjo analizë).

Nocionet e përshkruara më lart janë të rrënjosura thellë në normat mbizotëruese të pranuar gjerësisht në Maqedoninë e Veriut, prandaj, kur burrat dështojnë në kryerjen e rolit të tyre si furnizues, kjo mund të bëhet kritike dhe të rezultojë në rritjen e pabarazive gjinore dhe praktikave të dëmshme ose efekteve anësore, të tilla si rritja e dhunës me bazë gjinore, konsumimi i alkoolit ose edhe vetëvrasja. Sjellje të tilla të dëmshme, megjithëse më shpesh praktikohen nga burrat²⁸, ndikojnë negativisht si mbi burrat ashtu edhe mbi gratë. Për fat të keq, nuk ekzistojnë studime kombëtare që fokusohen tek burrat që, për shembull, do të tregonin këtë ndikim bazuar në rastësi. Sidoqoftë, ekziston një studim mjaft solid i udhëhequr nga OSBE mbi Sigurinë dhe mirëqenien e grave që zbulon disa tipare të sjelljes më të zakonshme të dhunës midis partnerëve meshkuj që janë më pak të arsimuar dhe/ose pjesë e amvisërive

25 Connell, R., & Messerschmidt, JW (2005). Hegemonic Masculinity. GENDER & SOCIETY, 19(6), 829-859.

26 Cornwall A., Kariotis F., Lindisfarne N. (2016). Masculinities under Neoliberalism.

27 Scambor, E and Bergmann, N and Wojnicka, K and Belghiti-Mahut, S and Hearn, J and Holter, ØG and Gärtner, M and Hrženjak, M and Scambor, C and White, A (2014) Men and gender equality: European insights. Men and Masculinities, 17 (5). 552 - 577. ISSN 1097-184X

28 Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së së Punëve të Brendshme, 94% e të gjithë kryerësve të dhunës në familje janë meshkuj (të dhënat e fundit të disponueshme - nga viti 2017)

që kanë vështirësi ekonomike.²⁹ Studime të tjera gjithashtu tregojnë se kontrolli i perceptuar i humbur mbi maskulinitetin normativ që ju përshkruhet burrave shpesh rezulton me abuzim të substancave dhe sjellje të dhunshme.³⁰ Të dhënat administrative të mbledhura nga institucionet përkatëse të Maqedonisë së Veriut për kryerësit e raportuar dhe të dënuar të veprave penale dhe për kryerësit e akuzuar sipas llojit të veprave të dhunshme penale, për një periudhë prej dy dekadash (2000-2020), konfirmojnë më tej këto praktika dhe pabarazi. (Figura 5. dhe Figura 6.)

Duhet theksuar gjithashtu se si gratë ashtu edhe burrat mund të jenë viktimat e dhunës së kryer nga burrat. Gratë përbëjnë shumicën e viktimave kur bëhet fjalë për dhunën ndërpersonale nga partneri në të gjitha format e saj (psikologjike, ekonomike, fizike dhe seksuale). Sidoqoftë, viktimat e këtij lloji të dhunës me bazë gjinore të kryer kryesisht nga burrat mund të jenë gjithashtu edhe burra të tjerë (zakonisht burra që nuk i 'përshtaten normave të përcaktuara' – si për shembull burra homoseksualë, burra më të moshuar, emigrantë, pakica etnike, burra me aftësi të ndryshme, burra të pastrehë, por gjithashtu edhe fëmijë dhe djem).^{31 32}

29 Përfundimi i nxjerrë nga karakteristikat e partnerit të të anketuarit (dhuna psikologjike tregohet më shpesh nga gratë, partnerët e të cilave nuk kanë ndonjë arsimim formal (66%) sesa mesatarja (42%). Për dallim, ky numër bie në 34% në mesin e grave, partnerët e të cilave kanë arsim të lartë. E njëjta gjë vlen edhe për dhunën fizike, të dyja që nga moshja 15 vjeç (15% e partnerëve të të cilëve nuk kanë arsim formal kundrejt 6% të atyre partnerëve të cilët kanë të paktën arsim fillor) dhe në 12 muajt para anketës (7% kundrejt 2%). Marrë nga Anketa e udhëhequr nga OSBE-ja për Dhunën ndaj grave: Maqedonia e Veriut - Raporti i Rezultateve (maj 2019). Gjetet në: <https://www.osce.org/secretariat/419264>

30 Edström, J.; Aly, R.; Greig, A. and Walker, C. with Babenko, S.; Çağlar, M.; Kudaibergenova, D. and Müller, C. (2019) Masculinities and Transition: Enduring Privilege?, Brighton: IDS

31 Ibid.

32 Scambor, E., Wojnicka, K. dhe Bergmann, N. (Eds.). 2013. The role of men in gender equality. European strategies & insights (study prepared for European Commission, DG Justice - Unit D2 Gender equality. With contributions by Belghiti-Mahut, S., Bergmann, N., Gärtner, M., Hearn, J., Holter, Ø. G., Hrženjak, M., Puchert, R., Scambor, C., Scambor, E., Schuck, H., Seidler, V., White, A. and Wojnicka, K.). Luxembourg: Publications Office of the European Union.

Kryerës të veprave penale të raportuar dhe të dënuar sipas gjinisë.




Figura 5. Kryerës të veprave penale të raportuar dhe të dënuar sipas gjinisë.

Burim: Zyra Shtetërore për Statistikë (N).

Dhunues të akuzuar sipas veprave penale




Figura 6. Kryerës të akuzuar sipas llojit të krimeve të dhunshme, sipas gjinisë, 2020.

Burim: Zyra Shtetërore për Statistikë (N).

Nga ana tjetër, burrat janë pjesa më e madhe e viktimave kur bëhet fjalë për krimet e dhunshme, siç janë sulmet serioze dhe vrasjet, të kryera nga burra të tjerë. Për më tepër, burrat gjithashtu kanë gjasa më të larta për vetëvrasje.




Figura 7. Numri i vdekjeve të dhunshme sipas gjinisë.

Burim: Zyra Shtetërore për Statistikë.

Dhuna e drejtpërdrejtë ose ndërpersonale, siç janë krimet e dhunshme, mund të lidhet me dhunën strukturore që prodhon dhe prodhohet nga pabarazitë sociale ndërsa studimet kanë treguar se një parashikues i rëndësishëm i niveleve të dhunës së drejtpërdrejtë në një shoqëri është madhësia e pabarazisë së të ardhurave^{33,34}. Në këtë drejtim, Maqedonia e Veriut karakterizohet me pabarazi të konsiderueshme sociale - 1% e më të pasurve fitojnë 14 herë më shumë se mesatarja,³⁵ ndërsa 32.6% janë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social (krahasuar me mesataren e BE-27 që është 21.5%)³⁶. Megjithatë, ekziston një mungesë e provave relevante kombëtare se si këto pabarazi lidhen me nivelet e dhunës.

Siç kemi theksuar tashmë, një nga recetat kryesore të maskulinitetit normativ është që burrat të jenë furnizuesit në familjen bërthamë ndërsa puna e paguar ende është burimi qendror i identitetit dhe

33 Wilkinson R. Why is violence more common where inequality is greater? Ann N Y Acad Sci. 2004 Dec;1036:1-12.
 34 Hsieh C-C, Pugh MD. Poverty, Income Inequality, and Violent Crime: A Meta-Analysis of Recent Aggregate Data Studies. Criminal Justice Review. 1993;18(2): 182-202.
 35 Ministria e Financave 2018. "Futja e taksë së drejtë në Republikën e Maqedonisë". Në dispozicionë: <https://bit.ly/2T5cVmJ>
 36 Eurostat (Last data update: 08/06/2022). People at risk of poverty or social exclusion, 2020

statusit të burrave³⁷. Presioni për të përmbushur këtë pritshmëri shoqërore mund të përkthehet në ankthe ekzistenciale dhe frustrim për shkak të mos qenit në gjendje të përmbushin rolet e përcaktuara në ekonomitë tranzicionale dhe moderne, të cilat gjithashtu mund të çojnë në sjellje të dhunshme. Studimet ndërkombëtare kanë treguar, për shembull, se papunësia rrit dhunën në familje. Burrat që humbasin punën e tyre kanë më shumë gjasa të shkaktojnë dhunë në familje ndërsa gratë që humbasin punën e tyre kanë më shumë gjasa të bëhen viktime të dhunës në familje.³⁸ Nuk ka ndonjë të dhënë të fuqishme kombëtare që konfirmon këto marrëdhënie, megjithatë, studimi rajonal i udhëhequr nga OSBE tregon se gratë, partneri aktual i të cilave është i papunë (17%), kanë më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim gjatë jetës së tyre krahasuar me ato, partneri i të cilave ka një punësim të paguar (13%).³⁹ Si një ekonomi tranzicionale, Maqedonia e Veriut ende mbetet pas vendeve të BE-së, me shkallë më të ulët të punësimit dhe aktivitetit (shih figurat 3 dhe 4) dhe shkallë më të lartë të papunësisë. Për më tepër, Maqedonia e Veriut ka një nga shkallët më të larta të të rinjve të cilët nuk janë as në punësim e as në arsim, në Evropë.⁴⁰

37 Scambor, E and Bergmann, N and Wojnicka, K and Belghiti-Mahut, S and Hearn, J and Holter, ØG and Gärtner, M and Hrženjak, M and Scambor, C and White, A (2014) Men and gender equality: European insights. *Men and Masculinities*, 17 (5). 552 - 577. ISSN 1097-184X

38 Bhalotra, S., Britto, D., Pinotti, P., and Sampaio, B. (2021), 'Domestic violence: the potential role of job loss and unemployment', CAGE Policy Briefing (No.34)

39 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave: Raporti kryesor, 2019; në dispozicion në: https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/413237_0.pdf

40 Eurostat (përditësimi i fundit: 11/05/2022). Young people neither in employment nor in education and training by sex, age and labour status (NEET rates), 2020




Figura 8. Të rinjtë (nga mosha 15 deri në 29 vjeç) as në punësim, as në arsim dhe trajnim (NEET).

Burimi: Eurostat.

Bazuar në shkaqet e përmendura, këta të rinj janë në rrezik të përjashtimit social dhe ekziston një pyetje e hapur që ngel e pa përgjigjigjur: sa nga dhuna strukturore mund të përkthehet në dhunë aktuale në rastin e tyre? Praktikrat patriarkale që formësojnë jetën e djemve dhe burrave në maskulinitet hegjemonik ose toksik dëmtojnë shumë gra dhe burra, duke i shërbyer status quo-së së sistemit patriarkal dhe neoliberal. **Kjo imponon një domosdoshmëri të menjëhershme për të punuar me burrat, por edhe me të rinjtë e sidomos me djemtë.** Meqenëse burrat kanë më shumë gjasa të jenë kryerës të veprave ata gjithashtu mund të jenë viktima të dhunës, është e domosdoshme që ata të përfshihen si agjentë të parandalimit të dhunës dhe DhBGj⁴¹.

41 Scambor, E and Bergmann, N and Wojnicka, K and Belghiti-Mahut, S and Hearn, J and Holter, ØG and Gärtner, M and Hrženjak, M and Scambor, C and White, A (2014) Men and gender equality: European insights. Men and Masculinities, 17 (5). 552 - 577. ISSN 1097-184X

KAPITULLI 2

KORNIZA LIGJORE DHE PËRGJIGJA INSTITUCIONALE

Ky kapitull zbaton një analizë ligjore në të cilën korniza analitike është vendosur përmes standardeve ndërkombëtare dhe rajonale për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht trajtimin e kryerësve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Standardet ndërkombëtare dhe rajonale shërbejnë për të vlerësuar shkallën e pajtueshmërisë dhe përshtatshmërisë së kornizës ligjore vendase në përmbushjen e detyrimit pozitiv të ndërmarrë nga nënshkrimi dhe ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare.

Analiza gjithashtu paraqet gjendjen faktike kur bëhet fjalë për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje dhe në veçanti zbatimin e masave parandaluese dhe funksionimin e programeve të trajtimit për kryerësit, në mënyrë që të përshkruhen më mirë boshllëqet në politika dhe sfidat me të cilat përballen viktimat që kanë përjetuar dhunë. Analiza merr parasysh hulumtimet dhe analizat përkatëse në terren, si dhe të dhënat statistikore dhe administrative të mbledhura nga institucionet dhe organizatat përkatëse.

STANDET NDËRKOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA ME BAZË GJINORE

Në nivel ndërkombëtar, Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW) nga viti 1979 është dokumenti i parë që obligon ligjërisht dhe një nga dokumentet më të rëndësishme që mbron arritjen e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave, e cila është kryesore në trajtimin e dhunës me bazë gjinore kundër grave. Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave për herë të parë definon dhunën me bazë gjinore⁴² dhe përcakton detyrimet e shteteve nënshkruese për të siguruar mbrojtje adekuate për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.⁴³ Rekomandimet e komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave janë një katalizator në përmirësimin e ligjeve kombëtare të shteteve anëtare, por edhe ngritjen e standardeve ndërkombëtarisht për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Dokumentet e miratuara në nivel të KB-së kanë ndikuar padyshim në sistemet rajonale të të drejtave të njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka marrë vendime që kanë një ndikim kryesor në krijimin e praktikës gjyqësore në rastet e dhunës ndaj grave dhe janë një element përbërës në krijimin e së drejtës

42 Komisioni për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19, Dhuna ndaj grave, 1992.

43 Komisioni për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35 dhuna me bazë gjinore ndaj grave, përditësimi i rekomandimit të përgjithshëm nr.19, 2017.

ndërkombëtare. Në vendimin Opuz kundër Turqisë të vitit 2009, GjEDNJ konstatoi se “dhuna familjare është diskriminim ndaj një gruaje... ndërsa dhuna e vazhdueshme familjare për të cilën viktimat nuk merr asnjë mbrojtje nga shteti është një shkelje e ndalimit të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe dënimit.”⁴⁴

Gjatë dy dekadave të fundit, Këshilli i Evropës ka ndërmarrë një sërë iniciativash për të promovuar dhe mbrojtur gratë nga dhuna, duke përfshirë Rekomandimin Rec (2002)⁴⁵ të Komitetit të ministrave i shteteve anëtare për mbrojtje të grave nga dhuna. E ndërtuar mbi Rekomandimin (2002)⁴⁶, në vitin 2011, Këshilli i Evropës miratoi Konventën për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës Familjare, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit. Pas më shumë se shtatë viteve të avokimit aktiv dhe lobimit nga organizatat e të drejtave⁴⁷ të grave, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më në fund ratifikoi Konventën e Stambollit në dhjetor 2017, ndërsa ka hyrë në fuqi që nga 1 korriku 2018. Në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, teksti i Konventës së Stambollit është pjesë e sistemit ligjor të shtetit,⁴⁷ por ratifikimi i saj ka krijuar gjithashtu një detyrim për institucionet kompetente që të rishikojnë kornizën ligjore ekzistuese dhe të ndërmarrin veprime për të adresuar në mënyrë efektive shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj grave.

Normat shoqërore që dalin nga pritja kolektive e sjelljes së duhur që përfshijnë pastërtinë femërore, ruajtjen e nderit të një burri dhe autoritetin e një burri në disiplinimin e grave dhe fëmijëve gjithashtu mbështesin dhunën me bazë gjinore. Prandaj, vendosja e programeve parandaluese, ndër të tjera, duhet të ndikojë në ndryshimin e normave shoqërore dhe besimeve personale që ruajnë dhe tolerojnë dhunën seksuale dhe format e tjera të dhunës ndaj grave dhe vajzave.⁴⁸ Puna me ushtruesit e dhunës në familje, e cila implikon përgjegjësinë e tyre për dhunën e kryer dhe në të njëjtën kohë duke ndryshuar perceptimin e tyre për marrëdhëniet gjinore, mbështetet gjithashtu nga Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave; Platforma e Pekinit për Veprim dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së.⁴⁹ Konventa e Stambollit imponon një detyrim për vendet nënshkruese për të zbatuar ndërhyrjet parandaluese dhe për të krijuar programe trajtimi për të ndihmuar kryerësit e dhunës të ndryshojnë sjelljen e tyre dhe për të parandaluar dhunën në të ardhmen. Sipas natyrës së Konventës, këto programe duhet të inkurajojnë kryerësit e krimeve të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të hetojnë sjelljen dhe qëndrimet e tyre ndaj grave. Hartuesit e Konventës nuk kanë për qëllim të detajojnë mënyrën e krijimit

44 ECHR, Opuz v. Turkey, No. 33401/02, 9 June 2009

45 Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec (2002)⁵ mbi mbrojtjen e grave nga dhuna (30 prill 2002).

46 Aktivistët kërkuar ratifikimin dhe u bashkuan me fushatën ndërkombëtare "Nënshkruaj!" në dispozicion në: <http://www.potpisuvam.org/mk/>

47 Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë Nr.52/1991; 1/1992; 1/1992; 31/1998; 31/1998; 91/2001; 91/2001; 84/2003; 84/2003; 107/2005; 107/2005; 3/2009; 3/2009; 13/2009; 49/2011; 49/2011; 6/2019; 6/2019. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Neni 118.

48 Perrin, N., Marsh, M., Clough, A. et al. Normat dhe besimet shoqërore rreth shkallës së dhunës me bazë gjinore: një masë për përdorim me programet e parandalimit të dhunës me bazë gjinore në mjediset me burime të ulëta dhe rrethana humanitare (2019). Në dispozicion në: <https://doi.org/10.1186/s13031-019-0189-x>

49 Rekomandimi Nr. 19 para 24 i Komitetit CEDAW. Objektivat Strategjike të Platformës së Pekinit ku citohet deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

dhe funksionimit të këtyre programeve, megjithatë qëllimi përfundimtar i këtyre programeve duhet të jetë parandalimi i përsëritjes së dhunës dhe nxitjes së riintegritit të suksesshëm të kryerësve të dhunës në bashkësi.

STANDARDET KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA ME BAZË GJINORE

Gjatë vitit 2018, pas realizimit të një procesi përgatitor, shteti miratoi **Planin për veprim për zbatimin e Konventës për parandalim dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018-2023** (në tekstin e mëtejshëm: Plani për veprim).⁵⁰ Përgatitja e këtij Plani për veprim ka përfshirë përfaqësues të institucioneve shtetërore, gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë, ndërsa qëllimi ka qenë të përcaktohet një kornizë për veprimin e të gjitha palëve të interesuara, në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë periudhën prej vitit 2018-2023, dhe në drejtim të rimendimit të tekstit të Konventës së Stambollit në politikat dhe praktikat në nivel kombëtar, ky Plan për veprim përcakton tre synime kryesore: 1) harmonizimin e kornizës ligjore; 2) krijimin e shërbimeve dhe 3) parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në fushën e harmonizimit të kornizës ligjore, Plani për veprim parashikon miratimin e një Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore të veçantë, ndërsa në fushën e shërbimeve, parashikon ngritjen e një qendre këshillimi për kryerësit e dhunës në familje dhe zhvillimin e duhur të standardeve operacionale dhe procedurave për qendrat e këshillimit për kryerësit e dhunës në familje.

Në janar 2021, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miratoi **Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj femrave dhe dhunës familjare**⁵¹, i cili synon zbatimin e Konventës së Stambollit duke përshkruar procedurën për mbrojtjen e viktimave të dhunës, koordinimin sistematik dhe bashkëpunimin e të gjitha autoriteteve dhe institucioneve, si dhe detyrimet e palëve përkatëse për të parandaluar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Ligji ofron përkufizimet e termave të përdorura në tekst, ndërsa në pjesën më të madhe ajo pasqyron frymën e Konventës së Stambollit. Kështu, ligji definon **“dhunën ndaj grave”** si shkelje të të drejtave të njeriut, diskriminim ndaj grave dhe i referohet të gjitha akteve të dhunës me bazë gjinore që çojnë në ose ka të ngjarë të çojnë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënime dhe frikësime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të tilla si zhvatja, kufizime arbitrare dhe/ose privim të lirisë, pavarësisht nëse ato ndodhin në jetën publike ose private. Përveç përkufizimit të dhunës në familje, e cila mund të lidhet me dhunën midis partnerëve dhe dhunën midis gjeneratave, ligji përcakton në mënyrë specifike **“dhunën e një partneri intim”** si sjellje e një bashkëshorti ose partneri aktual ose të mëparshëm që shkakton dhunë fizike, seksuale, psikologjike ose

50 Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Plani për veprim për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të Republikës së Maqedonisë 2018-2023, 2018.

51 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna familjare.

ekonomike. **Kodi Penal**, i cili ndalon disa nga format e dhunës me bazë gjinore të njohura nga Konventa e Stambollit, përmban një përkufizim më të ngushtë të termave **“dhunë familjare”** dhe **“viktimë”**.⁵² Siç përshkruhet nga Konventa e Stambollit, **“dhunues”** në kuptimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje është çdo person fizik dhe juridik që ka kryer ose nuk ka ndërmarrë asnjë nga veprimet që bien në përkufizimin e dhunës ndaj grave; dhuna me bazë gjinore; dhuna në familje dhe dhuna nga një partner intim, ndërsa **“viktimë”** është çdo person fizik që i është i ekspozuar ndaj njëres nga format e dhunës të përcaktuara në Ligj. Në këtë aspekt, ekziston një mosmarrëveshje ose mungesë përafrimi të përkufizimit të “viktimës” në Kodin Penal, i cili ndjek penalisht kryerësit e disa formave të dhunës me bazë gjinore. Konkretisht, përkufizimi në Kodin Penal kërkon një kriter shtesë për ndjekjen penale dhe kjo është ekzistimi i lëndimit fizik dhe mendor, vuajtjes emocionale, humbjes materiale ose një lëndimi tjetër ose rrezikimit të lirive dhe të drejtave të viktimës si pasojë e krimit të kryer, i⁵³ cili ngushton kuptimin e statusit të viktimës. Ndryshimet e vazhdueshme në Kodin Penal duhet të jenë komplementare me Konventën e Stambollit dhe Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna kundër grave dhe dhuna familjare, duke forcuar kështu mbrojtjen penale-ligjore të viktimave dhe duke siguruar që autorët e krimit do të mbahen përgjegjës për kryerjen e çdo forme të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës familjare.

Njohja e dhunës ndaj grave si shkelje e të drejtave të njeriut thekson forcën detyruese me ligj të obligimit për të parandaluar, eliminuar dhe penalizuar dhunën, duke vendosur gjithashtu një përgjegjësi ligjore nëse autoritetet nuk i përmbahen këtij obligimi. Konventa e Stambollit bazohet në supozimin se nuk janë të gjithë burrat të dhunshëm dhe se të gjithë anëtarët e shoqërisë mund të japin një kontribut të rëndësishëm në parandalimin e dhunës. Sidoqoftë, shumica e fushëveprimit të Konventës së Stambollit dhe kështu Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, i referohet formave të dhunës që kryhen më shpesh nga burrat dhe djemtë⁵⁴ dhe prandaj është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje e veçantë rolit të tyre në trajtimin e shkaqeve dhe pasojave të dhunës ndaj grave. Kur bëhet fjalë për dhunuesit, studimi i OSBE-së i vitit 2018 zbulon se dhuna fizike dhe/ose seksuale ka pak më shumë gjasa të kryhet nga një ish-partner: 12% e grave që kanë pasur një ish-partner kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës. Së tillë, krahasuar me 7% të atyre që kanë qenë viktimë të dhunës nga partneri aktual.⁵⁵

52 Gjatë periudhës së përgatitjes së kësaj analize, Propozimi për ndryshime të Kodit Penal për harmonizim me dispozitat e Konventës së Stambollit u soll në kuvend, për procedurë shqyrtimi. Propozimi adreson pjesërisht mangësitë e identifikuar në këtë analizë, por kodi nuk ndryshoi gjatë periudhës së përgatitjes dhe përfundimit të kësaj analize.

53 Gazeta Zyrtare e RM Nr. 80/1999; 48/2001; 4/2002; 16/2002; 43/2003; 19/2004; 40/2004; 81/2005; 50/2006; 60/2006; 73/2006; 87/2007; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 143/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014; 199/2014; 196/2015; 226/2015; 97/2017; 170/2017; 248/2018. Kodi Penal, Neni 122 P.22.

54 Këshilli i Evropës. Raporti shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011, f. 17.

55 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketë e OSBE-së për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, 2019.

Maqedonia e Veriut është e detyruar të miratojë një kornizë ligjore që do të lejojë krijimin ose mbështetjen e një programi që synon t'u mësojë kryerësve të dhunës në familje të përvetësojnë sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndër-personale në mënyrë që të parandalojnë dhunën e mëtejshme dhe të ndryshojnë modelet e dhunshme të sjelljes.⁵⁶ Konventa e Stambollit thekson sidomos detyrimin për të **krijuar ose mbështetur programe të hartuara veçanërisht që synojnë trajtimin e dhunuesve të dënuar të të gjitha formave të dhunës seksuale për të zvogëluar rikthimin në ekzekutimin e krimeve kundër lirisë seksuale**. Këto programe duhet të jenë të disponueshme në burgjet ku këta persona vuajnë dënimin me burg ose në bashkësinë ku ata do të vazhdojnë të përdorin shërbimet edhe pas vuajtjes së dënimit.

SHËRBIME PËR VIKTIMAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS FAMILJARE

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhunës familjare (LPMDhFDhF) parashikon disa shërbime të specializuara për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, buxhetet e njëjësive për vetëqeverisje lokale si dhe nga burime të tjera.⁵⁷ Ligji parashikon krijimin e shërbimeve të specializuara si më poshtë:

- Linjë SOS 24 orë;
- Shërbimi për këshillim (mbështetje psiko-sociale, këshillim dhe trajtim i grave dhe fëmijëve viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje);
- Shërbimi për akomodim të përkohshëm për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijët e tyre, gratë viktime të dhunës seksuale dhe përdhunimit, viktimat e trafikimit njerëzor dhe viktimat e dhunës në bazë të orientimit seksual dhe identitetin gjinor;
- Shërbimi për mbrojtje përkrahje të grave viktime të dhunës seksuale dhe përdhunimit në një qendër për referimin e viktimave të dhunës seksuale;
- Shërbim për trajtim afatgjatë të grave viktime të dhunës seksuale dhe përdhunimit të ofruar nga një qendër për këshillim dhe psikoterapi afatgjate;
- Ndhima juridike falas në përputhje me ligjet kombëtare; dhe
- Riintegrimi i viktimave të dhunës.

Në vitin 2021, MPPS miratoi Rregulloren e cila rregullon normat dhe standardet për qendrat për shërbim të përkohshëm të akomodimit.⁵⁸ Përveç kësaj, në përputhje me Planin për veprim, Instituti për Çështje

⁵⁶ Council of Europe. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, neni 14.

⁵⁷ Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NDAJ FEMRAVE DHE DHUNA FAMILJARE, NENI 89.

⁵⁸ Gazeta zyrtare e rmv nr. 91/2021. Rregullore për mënyrën, fushëveprimin, normat dhe standardet për ofrimin e shërbimit social për akomodim të përkohshëm dhe për hapësirën, mjetet, personelin dhe dokumentacionin e nevojshëm për qendrën për akomodim të përkohshëm.

Sociale përgatiti disa procedura standarde operacionale për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare.⁵⁹ Për më tepër, disa institucione kombëtare kanë përgatitur një procedurë standarde operative për një përgjigje gjithëpërfshirëse multisektoriale në qendrat për referimin e dhunës seksuale të cilat ndodhen në institucionet e shëndetit publik në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë.

SHËRBIMET PËR TRAJTIMIN PSIKO-SOCIAL TË DHUNUESVE

Kur bëhet fjalë për masat parandaluese, **Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje** parashikon krijimin e këshillimit për trajtimin psiko-social të ushtruesve të dhunës në familje.⁶⁰ **Shërbimet për këshillim rregullohen më tej në hollësi nga Akti për mbrojtje sociale** dhe ato përfshijnë punën këshilluese, me qëllim parandalimin, zbutjen dhe tejkalimin e pasojave të problemeve sociale të një individi dhe familjes.⁶¹ Sipas Planit për veprim, **janë planifikuar të hapen gjithsej dhjetë qendra këshillimi për mbështetje psiko-sociale për viktimat e dhunës në familje, kryerësit e dhunës në familje dhe fëmijët, në territorin e gjithë vendit deri në vitin 2023**. Mënyra se si ky tregues është vendosur në Planin për veprim çon në përfundimin se në një qendër këshillimi do të marrin shërbime tre kategoritë e personave, ndërsa sipas situatës faktike, gratë dhe fëmijët, viktimat e dhunës kanë nevojë për lloje të ndryshme këshillimi, krahasuar me atë që kanë nevojë dhunuesit. Në mënyrë plotësuese, vendosja e këtyre shërbimeve në një vend mund t'i vendosë viktimat në rrezik shtesë, gjë që është në kundërshtim me standardet e Këshillit të Evropës.⁶²

Në vitin 2021, MPPS miratoi Rregulloren që rregullon normat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të këshillimit në qendrat e këshillimit.⁶³ Ofruesi i shërbimit të këshillimit duhet të përmbushë normat dhe standardet e përshkruara në Rregullore për sa i përket hapësirës, pajisjes, personelit, planit vjetor për burimet financiare, punës në një mjedis jo-diskriminues si dhe procedurave të brendshme për vlerësimin e shërbimit të ofruar social. Sipas Rregullores, qendra e këshillimit duhet të ketë dhoma të ndara për punë individuale dhe në grup (ose një dhomë të përbashkët që përdoret për punë individuale dhe në grup) me dimensione specifike. Në lidhje me të punësuarit, qendra e këshillimit duhet të ketë të paktën një punëtor social dhe një psikolog me licencë të specializuar, njëri prej të cilëve emërohet si koordinator i qendrës. Kjo Rregullore nuk jep ndonjë kriter specifik në lidhje me kualifikimet dhe përvojën e punës

59 Institucioni publik instituti për çështje sociale. Standardet dhe procedurat për funksionimin e qendrave për punë sociale me viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës familjare, standardet dhe procedurat për funksionimin e ofruesve të shërbimeve të akomodimit të përkohshëm, standardet dhe procedurat për ofruesit e licencuar të shërbimit të specializuar të këshillimit – shërbime të specializuara për gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat të dhunës familjare, standardet dhe procedurat për funksionimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve të specializuara – linja sos për ndihmën e viktimave të dhunës, 2021.

60 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna familjare, neni 39.

61 Gazeta Zyrtare e RMV Nr 104/2019; 146/2019; 275/2019; 302/2020; 311/2020 dhe 163/2021. Social Protection Act, Article 73.

62 KËSHILLI I EVROPËS, Lufta kundër dhunës ndaj grave: standardet minimale për shërbimet mbështetëse, 2008.

63 Gazeta zyrtare e rmv nr. 84/2021. Rregullore për mënyrën, fushëveprimin, normat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe për hapësirën, mjetet, personelin dhe dokumentacionin e nevojshëm për qendrat e këshillimit.

së personelit. Sipas të dhënave që janë në dispozicion në ueb faqen e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, në periudhën e përgatitjes së kësaj propozim analize, janë themeluar tetë qendra këshillimi të shpërndara në tetë rajone statistikore për të trajtuar autorët e krimeve. Megjithatë, ka mungesë informimi lidhur me kapacitetin hapësinor të nevojshëm për shërbimet e tilla, numrin dhe llojin e personelit që ofron shërbime të tilla, si dhe çdo informacioni nëse personeli përgjegjës, nëse ka, kryer trajnimet e duhura profesionale për të qenë në gjendje të punojë me dhunuesit. Përveç kësaj, raportet në hije zbulojnë se 6 prej këtyre qendrave nuk janë funksionale për shkak të mungesës së burimeve njerëzore ndërsa menaxherët e rasteve janë të angazhuar në qendrat për punë sociale.⁶⁴

Sipas Planit për veprim, në vitin 2018, Instituti për Çështje Sociale përgatiti Procedurat Standarde Operative (PSO) për funksionimin e qendrës së këshillimit për ushtruesit e dhunës në familje.⁶⁵ Sipas PSO-ve, trajtimi psiko-social i dhunuesve kryhet në një dhomë të veçantë nga një psikolog, punëtor social, edukator dhe psikiatër i cili duhet të posedojë një certifikatë pune të lëshuar në kuadër të Programit për trajtim psiko-social, por nuk ka kriteret specifike në lidhje me njohuritë dhe përvojën e nevojshme në lidhje me çështje specifike që lidhen me dhunën me bazë gjinore. **Kryerja e këtij lloji të ndërhyrjes kërkon personel të aftë dhe të trajnuar.** Përveç edukimit të duhur psikologjik dhe njohjes së natyrës së dhunës familjare, personeli i punësuar duhet medoemos të posedojë aftësi kulturore dhe gjuhësore që do t'u mundësojnë atyre të punojnë me lloje të ndryshëm të burrave që do të jenë pjesë e këtij programi.⁶⁶ Për të zbatuar vazhdimisht Obligimin nga Konventa e Stambollit, është e nevojshme që për trajtimin e autorëve të krimeve të angazhojnë personel që kanë të paktën 30 orë trajnimi për tema që kanë të bëjnë me analizën gjinore të dhunës ndaj grave; perspektiva dhe përvoja të femrave; manipulimet nga abuzuesit; përvoja e fëmijëve; korniza ligjore; dallimet; abuzimi me substancat; si dhe të kuptuarit e procesit të ndryshimit dhe vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut.⁶⁷

Një nga parimet themelore të punës me autorët e krimit është fshehtësia e të dhënave dhe një qasje e koordinuar.⁶⁸ Prandaj, e drejta e konfidencialitetit të kryerësit të dhunës në programin e trajtimit është e kufizuar dhe fakti që ai është larguar nga programi ose nuk viziton rregullisht duhet të ndahet me programet për këshillim dhe mbrojtje të viktimave si dhe me vetë viktimën.⁶⁹ Kështu, parimi i kujdesit të duhur do të ruajë sigurinë dhe do të zvogëlojë mundësinë e përsëritjes së dhunës nëse viktimat e di

64 Karovska Çemerska, D. HERA (2022). Raport mbi monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për zbatimin e konventës për parandalimin dhe

65 Institucioni publik Instituti për Çështje Sociale. Standardet dhe procedurat për funksionimin e qendrës së këshillimit për kryerësit e dhunës në familje, 2018.

66 Këshilli i Evropës. Raporti shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011.

67 Idem.

68 Institucioni publik Instituti për Çështje Sociale. Standardet dhe procedurat për funksionimin e qendrës së këshillimit për kryerësit e dhunës në familje, 2018.

69 KËSHILLI I EVROPËS. Raporti shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011.

se dhunuesi është larguar nga trajtimi, është pezulluar nga programi ose nëse ka ndonjë shqetësim në lidhje me sjelljen e dhunuesit që vë në rrezik gratë dhe fëmijët. Standardet për zbatimin e shërbimeve specifike në përputhje me Konventën e Stambollit nënkuptojnë që shërbimet për dhunuesit dhe viktimat duhet të ndahen në lokacione të ndryshme dhe në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që këto shërbime të krijohen dhe të funksionojnë si të izoluar. Është thelbësore që këto shërbime të bashkëpunojnë me shërbimet për përkrahjen e grave, policinë, prokurorinë dhe gjykatat, shërbimet e provës dhe shërbimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Është veçanërisht e rëndësishme që programet për trajtimin e dhunuesve, por edhe i gjithë sistemi për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, të funksionojnë përmes prizmit të analizës gjinore të dhunës ndaj grave dhe të punojnë ngushtë me shërbimet sociale për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. PSO-të e përgatitura në nivel kombëtar nuk lejojnë mundësinë e përjashtimit të parimit të fshehtësisë dhe konfidencialitetit dhe nuk parashikojnë një procedurë të qartë për përjashtim nga programi dhe informimin e viktimës në rast të ndonjë anulimi, d.m.th. përjashtimin e dhunuesit nga programi.

BAZAT PËR T'U PËRFSHIRË NË NJË TRAJTIM PËR KRYERËSIT E DHUNËS NË FAMILJE

Dhunuesit mund të përfshihen në programet e trajtimit ose me vendim gjykatë ose me vendim vullnetar të dhunuesit. Në të dyja rastet, përfshirja e dhunuesit në një program trajtimi mund të ndikojë në vendimin e viktimës për të qëndruar ose për ta lënë abuzuesin dhe në krijimin e një ndjenjë të rreme sigurie. Si rezultat, është e rëndësishme t'i jepet përparësi nevojave dhe sigurisë së viktimës. Kjo është në përputhje me parimin e kujdesit të duhur të vendosur nga Konventa e Stambollit dhe e përkthyer nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje. Konkretisht, autoritetet shtetërore, subjektet juridike që ushtrojnë kompetenca publike të përcaktuara me ligj, zyrtarët qeverisës, administratorët publikë dhe personat e tjerë të autorizuar që kryejnë punë në emër të shtetit, janë të obliguar të përmbahen nga aktet e dhunës si dhe të marrin të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje.⁷⁰

Sipas PSO-ve, **referimi në një Qendër Këshillimi për kryerësit e dhunës** në familje mund të kryhet nga një gjykatë, qendër e punës sociale, policia, institucioni për kujdes shëndetësor ose bazuar nga një vetë-iniciativë e kryerësit të dhunës në familje. Në rast të dhunës, **viktimat kanë të drejtë për mbrojtje gjyqësore në procedurat penale dhe civile, por jo medoemos duhet të ndërmarrin ndonjë veprim ligjor për të qenë në mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre për një shërbim për mbrojtje nga dhuna.** Përveç kësaj, programet e trajtimit për autorët e krimit në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si një

70 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna familjare, neni 4.

alternativë për ndjekjen penale, dënimin ose vuajtjen e një dënimi. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje⁷¹ i jep gjykatës mundësinë, kur bëhet fjalë për procedurat civile, të vendosë **një masë të përkohshme për mbrojtje** ndaj autorit të veprës penale – **detyrim ligjor për të marrë pjesë në këshillime për autorët e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje**.⁷² Dispozita i mundëson gjykatës të vendosë një masë të tillë në rast të ndonjë forme të dhunës ndaj grave, ndërsa në praktikë vetëm autorët e dhunës në familje mund të përfshihen në programin e trajtimit për autorët e dhunës në familje.⁷³

Siç u shtjellua në kapitullin e mëparshëm, Maqedonia e Veriut karakterizohet nga një model i fortë tradicional i ndarjes së roleve gjinore. Burrat në përgjithësi konsiderohen si furnizuesit kryesorë, ndërsa gratë në rastin më të mirë mund të kontribuojnë me të ardhura shtesë. Kjo vlen si për çiftet ashtu edhe për individët, ndërsa kur bëhet fjalë për çiftet me fëmijë, gratë luajnë një rol kyç në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.⁷⁴ Mungesa e të kuptuarit të aspektit gjinor të dhunës familjare dhe dinamikës së marrëdhënieve rezultojnë në krijimin e një tendence negative në inicimin e procedurave për vendosjen e masave të përkohshme të mbrojtjes kundër dhunuesit të familjes (zakonisht babait) dhe nënës dhe në mbrojtjen e fëmijëve. Qendrat për Punë Sociale (QPS) lëshojnë një rekomandim për vendosjen e një mase të përkohshme mbrojtëse kundër nënës (një viktimë afatgjatë e dhunës në familje) me arsyetimin se ajo nuk ka arritur të mbrojë fëmijët e saj nga dhuna e babait. Një praktikë e tillë është e rrezikshme dhe në kundërshtim me standardet e Konventës së Stambollit, e cila kërkon zbatimin e një ndërhyrjeje që e vë viktimën në qendër ndërsa masat që ndërmerren duhet të respektojnë të drejtat e njeriut të viktimës. Veprimet e QPS rezultojnë në inkurajimin e dhunuesit për të vazhduar me dhunën – ato nuk parandalojnë dhunën në të ardhmen; riafirmojnë rolin gjinor të nënës si përgjegjëse e vetme për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve dhe komprometojnë rolin e viktimës duke e privuar atë nga shërbimet për mbrojtje nga dhuna dhe nga motivimi për të raportuar raste të dhunës në të ardhmen. Dekurajimi i viktimave nga raportimi i dhunës mund të jetë fatal, siç dëshmohej nga të dhënat e mësipërme, të cilat tregojnë se femicidi (vrasja e grave sepse janë gra) janë më të shpeshta tek gratë që nuk kanë raportuar kurrë dhunën.⁷⁵

71 KËSHILLI I EVROPËS. Lufta kundër dhunës ndaj grave: standardet minimale për shërbimet mbështetëse, 2008.

72 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna familjare, neni 58.

73 Institucioni publik Instituti për Çështje Sociale. Standardet dhe procedurat për funksionimin e qendrës së këshillimit për kryerësit e dhunës në familje, 2018.

74 Reaktor-Hulumtim në Veprim. BURRAT DHE KUJDESI (BDHK) : Mashkulloritet i kujdesshëm në Maqedoninë e Veriut: raport kombëtar, 2021.

75 Is. Dimushevska. Femicidet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shkup 2021.

KRITERET PËR PËRFSHIRJE NË PROGRAM

Standardet e Këshillit të Evropës imponojnë një detyrim për të vendosur kritere të qarta për pranim në program dhe për të përgatitur një vlerësim të rrezikut para se të hyjë dhunuesi në trajtim. Procedura për trajtimin psiko-social të autorëve të dhunës në familje përcakton kriteret që një person të kualifikohet për trajtim, si vijon: të ketë një rast të dhunës në familje; të mos jetë i varur nga substancat psikoaktive; të mos ketë sëmundje mendore akute që mund të komplikojë trajtimin dhe motivim personal për përfshirje dhe gatishmëri për të ndryshuar nga ana e kryerësit.⁷⁶ **Pranimi bazohet në vlerësimin nëse personi i plotëson këto kushte dhe jo në bazë të vlerësimit të rrezikut për gratë dhe fëmijët që janë viktimat të dhunës.** Standardet minimale për funksionimin e programit për autorët e dhunës kërkojnë një vlerësim të përshtatshmërisë së klientit për pranim në program, por edhe një vlerësim të vazhdueshëm të rrezikut në pajtim me kushtet ekzistuese. Në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna familjare, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale miratoi një rregullore që rregullon mënyrën në të cilën realizohet procedura për vlerësimin e rrezikut për rrezik serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës, përfshirë dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës.⁷⁷ Krahas masave të tjera, ekspertët gjithashtu po ndërmarrin masa dhe aktivitete ndaj kryerësit të dhunës që kanë për qëllim ndryshimin e sjelljes së tij dhe parandalimin e dhunës në të ardhmen. Megjithatë, **Procedura për trajtimin e kryerësve nuk imponon një vlerësim të rrezikut para pranimit dhe gjatë trajtimit në kuadër të programit.** PSO-të nënkuptojnë që të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të ushtrojnë një praktikë të standardizuar që kërkon të identifikojë qartë fajësinë dhe të përcaktojë proceset që përqendrohen në nevojat e viktimave, veçanërisht në sigurinë e tyre dhe parandalimin e dhunës në të ardhmen.⁷⁸ **Mungesa e procedurave në institucionet përgjegjëse që rregullojnë trajtimin në rastet e dhunës në mënyrë shumë-sektoriale rezultojnë në mungesë koordinimi dhe vlerësimi real të rrezikut, i cili, siç ilustron shembulli i mësipërm, mund të ketë pasojë fatale për viktimën.**⁷⁹

Programet e trajtimit për autorët e krimeve nuk duhet të kthehen në një forum ku ne përpiqemi të pajtojmë partnerët, të këshillojmë partnerët ose të kryejmë një trajtim për menaxhim të zemërimit. Në praktikë, kjo ndodh shpesh në qendrat e punës sociale ndërsa pas raportimit të dhunës në familje, punëtorët profesionistë organizojnë një takim të përbashkët në të cilin përpiqen të pajtojnë partnerët dhe "relativizojnë" dhunën si marrëdhënie të prishur mes partnerëve. Në mënyrë të ngjashme, **policia**

76 Institucioni publik Instituti për Çështje Sociale. Standardet dhe procedurat për funksionimin e qendrës së këshillimit për kryerësit e dhunës në familje, 2018.

77 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 240/2021. Rregullat se si të kryhet vlerësimi i rrezikut të rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe rreziku i dhunës së përsëritur, menaxhimi i dhurës i rrezikut, zbatimimi dhe monitorimi i masave për të mbrojtur gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat të dhunës në familje, të marra nga Qendra e Punës Sociale dhe formularët e nevojshëm.

78 WAVE – Women against Violence Europe. Wave- Doracak. Standardet për parandalim dhe mbështetje për gratë e mbijetuar nga dhuna, 2017.

79 Karovska Čemerska, D. HERA (2022). Raport mbi monitorimin e zbatimit të planit për veprim për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; i disponueshëm në: <https://hera.org.mk/izvestaj-monitoring-ap-istanbulska-konvencija/>

shpesh reagon me qëllimin e pajtimit të partnerëve, që është edhe arsyeja se përse një numër i konsiderueshëm i raporteve të dhunës në familje regjistrohen si ankesa. Gjatë periudhës prill - qershor 2020, Ministria e Punëve të Brendshme ka regjistruar gjithsej 985 ankesa, që është 34% më shumë krahasuar me vitin 2019, ose 50% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ndërsa numri i përgjithshëm i krimeve që lidhen me dhunën në familje ka rënë krahasuar me vitet e mëparshme.⁸⁰ Ministria e Punëve të Brendshme vazhdimisht regjistron një numër dukshëm më të lartë të ankesave për raste të dhunës në familje në raport me krimet, jo vetëm në periudhën e kulmit të pandemisë me Kovid-19. Rrjedhimisht, në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 3196 ankesa përkundër 798 veprave penale kundër kryerësve të dhunës në familje, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 3759 ankesa përkundër 992 vepra penale kundër kryerësve të veprave penale.⁸¹ Numri i procedimeve penale të nisura përpara zyrave të prokurorisë publike është edhe më i vogël. Gjatë vitit 2019, gjithsej 276 raporte të dhunës në familje janë dorëzuar në 11 prokurori në territorin e vendit ndërsa 250 raporte të dhunës në familje në vitin 2020. Në të njëjtën periudhë, u iniciuan gjithsej 346 procedime penale kundër kryerësve të dhunës në familje në 25 gjykata në vitin 2019 dhe 355 procedura penale kundër kryerësve të dhunës në familje në vitin 2020. Të dhënat e marra tregojnë se një pjesë dukshëm më e vogël e krimeve të raportuara kundër kryerësve të dhunës në familje marrin vendime gjyqësore, sidomos duke pasur parasysh faktin se në disa raste viktimat heqin dorë nga ndjekja penale e kryerësit dhe tërheqin kërkesën për ndjekje penale e cila rezulton në mungesën e dënimit të kryerësve të raportuar.

Disa nga kryerësit e dhunës me bazë gjinore janë persona të varur nga substancat psikoaktive (alkooli, droga, medikamentet) dhe atyre u duhet një trajtim i specializuar që nuk mund dhe nuk duhet t'u jepet atyre brenda programit të përgjithshëm të trajtimit të kryerësve të dhunës. Sipas studimit të OSBE-së, një e pesta e incidenteve më serioze janë kryer nga dikush që ka qenë nën ndikimin e alkoolit ose drogës,⁸² ku varësia nga alkooli dhe opioidet shpesh paraqitet si një motiv shtesë dhe zakonisht kombinohet me marrëdhëniet konfliktuoze ose çrregullimet psikologjike në rastin e kryerjes së femicideve.⁸³ Varësia nga alkooli ose substanca të tjera psikoaktive përjashton dhunuesit nga trajtimi psiko-social i kryerësve të dhunës në familje, por nuk duhet të jetë arsye për të mos punuar me këta dhunues. Praktika e mirë imponon një detyrim për të lidhur dhe krijuar bashkëpunim midis programeve të trajtimit të varësive dhe programeve të trajtimit të dhunuesve me anë të protokolleve të shkruara dhe metodave dhe fazave të përcaktuara me saktësi për veprim. Për momentin nuk ka asnjë protokoll ose udhëzues të shkruar për të ndihmuar profesionistët të merren me kryerësit e dhunës dhe trajtimin e tyre të cilët përdorin substanca psikoaktive dhe janë të varur nga to.

80 N. Boshkova, D. Antiç, R. Bogatinova dhe M. Gliguroska. Të drejtat e njeriut të bashkësive të marginalizuara nën kushtet e Kovid-19: Raport mbi ndikimin që kanë masat për përballim me Kovid-19 mbi të drejtat e njeriut të bashkësive të marginalizuara, 2021, f. 24.

81 Ministria për Punë të Brendshme. Vendimi mbi përgjigjen nga kërkesa për lirinë e informimit nr. 16.1.2.-1530/1 nga 16.12.2021.

82 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Mirëqenia dhe siguria e grave: Anketa e OSBE-së për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, 2019.

83 Is. Dimushevska. Femicidet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shkup 2021.

ZBATIMI I MASËS SË PËRKOSSHME PËR TRAJTIMIN E DHUNUESVE

Mbrojtja efektive e grave që i kanë mbijetuar dhunës kushtëzohet nga mënyra se si zbatohen masat e përkohshme të mbrojtjes.

Sipas Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna familjare dhe me kërkesë të Qendrës për Punë Sociale ose me ankesë të bërë nga viktimat, gjykatat, ndër të tjerat, mund të lëshojnë një masë të përkohshme për kryerësin – një këshillim të detyrueshëm në një qendër këshillimi për kryerësit e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje. Të dhënat nga gjykatat civile (ose njësitë e tyre përkatëse rajonale), që mbulojnë periudhën 2019-2021, janë mjaft të pakta dhe zbulojnë përcaktimin sporadik të masave për një vizitë të detyrueshme në një qendër këshillimi për dhunuesit. Sipas të dhënave nga 26 gjykata civile (departamente) në periudhën 2019-2021, janë caktuar gjithsej 1494 masa të përkohshme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, ndërsa vetëm 11 gjykata kanë caktuar masa për masën - këshillim i detyrueshëm në qendër për dhunuesit. Shumica e këtyre propozimeve janë dorëzuar nga qendrat përkatëse për punë sociale, ndërsa rreth 3% nga të gjitha propozimet e paraqitura janë për përcaktimin e një mase të përkohshme - këshillimi i detyrueshëm në qendër për dhunuesit.

Sipas të dhënave të marra nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, në vitin 2019 janë dhënë gjithsej 22 propozime për dhënie të masës së përkohshme këshillim i detyrueshëm në një qendër për dhunuesit dhe po aq janë pranuar dhe dhënë nga gjykatat; në vitin 2020 janë propozuar 25 masa të përkohshme ndërsa janë shqiptuar 22 masa të përkohshme, përderisa në vitin 2021 janë propozuar 55 masa ndërsa gjykatat kanë shqiptuar 47 masa të përkohshme, vizitë e detyrueshme në një qendër këshillimore për dhunuesit.⁸⁴ Krahasuar me numrin e dhunuesve që janë këshilluar në qendrën e këshillimit për kryerës të dhunës në HERA në periudhën e njëjtë, mund të konkludohet se dhunuesit marrin pjesë në qendrën e këshillimit jo vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor, por edhe me referim nga një entitet tjetër ose me iniciativën e tyre. Gjegjësisht, vetëm qendra e këshillimit HERA ka ofruar këshillim për 45 dhunues në vitin 2019; për 65 dhunues në vitin 2020 dhe 51 dhunues në vitin 2021.⁸⁵

84 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Përgjigje nga kërkesa për lirinë e informimit nr. 14-1576/5 nga 23.03.2022.

85 Shoqata për edukim shëndetësor dhe kërkim, raporte vjetore. Më shumë në: <https://hera.org.mk/godishni-izveshtai/?lang=en>

Këshillim i detyrueshëm për kryerësit e DhF




Figura 9. Këshillim i detyrueshëm për dhunuesit për DhKG (Dhunë kundër grave) dhe DhF (Dhunë në familje) - numri i masave të përkohshme të sugjeruara për mbrojtje nga KSG (Komisioni për statusin e grave) dhe numri i masave të përkohshme të lëshuara nga gjykata.

Burim: Ministria për Punë dhe politikë sociale.

Qendrat e këshillimit për autorët e dhunës në familje janë përgjegjëse për zbatimin e masës së përkohshme të vendosur nga gjykata dhe janë gjithashtu përgjegjëse për të realizuar një vendim gjyqësor për mbikëqyrjen mbrojtëse në lidhje me detyrimin e vendosur për personin e dënuar që ka kryer një krim të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje për të hyrë në një program që punon me të dënuarit e krimeve të kryera gjatë ekzekutimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje si dhe për të informuar gjykatën për përmbushjen e kësaj përgjegjësie.⁸⁶ Siç është theksuar tashmë, PSO-të dhe procedurat për funksionimin e qendrave të këshillimit për autorët e dhunës në familje kanë të bëjnë vetëm me punën me kryerësit e dhunës në familje, kështu që ekziston një vakum ligjor për zbatimin e kësaj dispozite të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Zbatimi i masës së përkohshme – trajtimi i kryerësit të dhunës në familje - rregullohet sipas Rregullores. Çdo qendër për punë sociale është e detyruar të monitorojë zbatimin e masës së përkohshme të lëshuar dhe për këtë qëllim, të bashkëpunojë me qytetarët, personat juridikë, institucionet dhe shoqatat për të mbledhur informata me kohë dhe të sakta mbi efektet e zbatimit të masës dhe për të informuar

86 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 24/2021. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna familjare, neni 73.

gjykatën në mënyrë të duhur. Ofruesi i shërbimit për trajtimin psiko-social të kryerësve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje duhet të informojë Qendrën për Punë Sociale, të paktën një herë në muaj, për rrjedhën e trajtimit ndërsa pas trajtimit ai gjithashtu duhet të paraqesë një raport mbi ndikimet e trajtimit dhe ndryshimin e ose ndryshimin eventual në sjelljen e kryerësit.⁸⁷ Në rast të mosrespektimit dhe/ose shkeljes së masës së përkohshme të vendosur, Qendra për Punë Sociale është e detyruar të njoftojë menjëherë gjykatën. Sipas standardeve të vendosura nga Konventa e Stambollit, viktimat duhet të informohet për këtë me qëllim sigurie dhe të mbrojtjes së sigurisë së saj. Viktima gjithashtu duhet të raportojë në Qendrën për Punë Sociale në rast të ndonjë mosrespektimi dhe/ose shkeljeje të masës së lëshuar të përkohshme për mbrojtje.

PROGRAMET E TRAJTIMIT PËR KRYERËSIT E DHUNËS SEKSUALE

Dhuna seksuale është një nga format më të rënda të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe një problem serioz i shëndetit publik. Marrëdhënia e detyruar seksuale është një shprehje e fuqisë dhe dominimit mbi viktimën, ndërsa nganjëherë shërben për të ndëshkuar viktimën për tejkalimin e kodit të përgjithshëm shoqëror dhe moral.⁸⁸ Sipas Konventës së Stambollit, shteti është i detyruar të zbatojë reformat e nevojshme ligjore për të njohur të gjitha format e dhunës seksuale si akte penale-ligjore, duke krijuar shërbime të mbrojtjes emergjente për viktimat, në të njëjtën kohë, si dhe trajtim afatgjatë dhe mbështetje për viktimat e dhunës seksuale. Për një kohë të gjatë, vendimmarrësit nuk kanë përfillur përafrimin e legjislacionit penal me standardet ndërkombëtare në fushën e kriminalizimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhunës seksuale. Që nga viti 2013, Komisioni për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit, si pjesë e Konkluzioneve për Republikën e Maqedonisë së Veriut, ka theksuar shqetësimet për mungesën e një ligji specifik dhe gjithëpërfshirës që mbulon të gjitha format e dhunës, sidomos dhunën seksuale dhe për këtë arsye, ka rekomanduar ndryshimin e Kodit Penal në mënyrë që do të lejonte përcatimin e mbrojtjes, veçanërisht për viktimat e dhunës seksuale.⁸⁹ Rrjedhimisht, në vitin 2018, Komiteti theksoi nevojën për t'i dhënë përparësi miratimit të ndryshimeve dhe plotësimit të Kodit Penal në mënyrë që do të ndalonte të gjitha format e dhunës me bazë gjinore që ndodhin në një bashkësi martesore dhe jashtëmartesore, veçanërisht përdhunimin. Komiteti gjithashtu ka rekomanduar që shteti duhet të rivedojë krimin e përdhunimit, duke hedhur poshtë depërtimin si një element kyç dhe formulimin e mungesës së pajtimit si shenjën kryesore dalluese për këtë krim.⁹⁰ Në momentin e përmbjlljes së kësaj analize, kishte një proces të vazhdueshëm që përpqej t'i adresonte këto rekomandime ndërsa Kuvendi

87 Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 248/2021. Rregullat për mënyrën e zbatimit të masave të imponuara mbrojtëse, neni 11.

88 Organizata Botërore e Shëndetësisë. Fakte për dhunën seksuale. Në dispozicion në: https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/world_report/factsheets/en/sexualviolence_mac.pdf

89 Komisioni për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Vërejtjet përmbjllëse mbi raportin e katërt dhe të pestë periodik të kombinuar të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të miratuar nga Komiteti në sesionin e tij të pesëdhjetë e katërt (11 shkurt-1 mars 2013) CEDAW/C/MKD/CO/4-5, çift. 22 dhe 23.

90 Komisioni për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Vrojtmet përmbjllëse mbi raportin e gjashtë periodik të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, CEDAW/C/MKD/CO/6, 2018, par.24

i Republikës së Maqedonisë së Veriut ende nuk ka miratuar ndryshimet e dorëzuara për Kodin Penal, të cilat mund të mundësojnë një përafrim të pjesshëm të kornizës ligjore me Konventën e Stambollit dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

Përpjekjet për të parandaluar dhunën seksuale duhet të përqendrohen kryesisht tek viktimat dhe nevojat e saj për të zvogëluar traumën dhe për të përshpejtuar shërimin. Konventa e Stambollit thekson veçanërisht detyrimin për të krijuar ose mbështetur programe të hartuara veçanërisht që synojnë trajtimin e dhunuesve të dënuar të të gjitha formave të dhunës seksuale për të zvogëluar rikthimin në ekzekutimin e krimeve kundër lirisë seksuale. Trajtimi i kryerësve të dhunës seksuale duhet të jetë në dispozicion në burgjet ku këta persona vuajnë dënimin me burg ose në një bashkësi ku do të vazhdojnë të përdorin shërbimet pas vuajtjes së dënimit të tyre.

Në Maqedoninë e Veriut mungojnë shërbimet për punë afatgjate me viktimat e dhunës seksuale, si dhe programet për trajtimin e kryerësve të dhunës seksuale. Në vitin 2018, janë hapur tre qendrat e para të referimit për viktimat e përdhunimit, në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë. Këto qendra janë pjesë e klinikave gjinekologjike-obstetrike në këto tre qytete dhe drejtohen nga Ministria e Shëndetësisë. Këto qendra janë qendra referimi, që do të thotë se kur një viktimitë e përdhunimit pranohet, i ofrohet kujdes mjekësor ndërsa rasti do të raportohet në polici. Këto tre qendra referimi janë të vetmet në nivel kombëtar të dizajnuara ekskluzivisht për të mbështetur gratë që janë viktimat të përdhunimit.⁹¹ Statistikat jozyrtare tregojnë se vetëm 6 gra kanë vizituar qendrën në Shkup, ndërsa qendrat në Kumanovë dhe Tetovë nuk kanë pasur raporte që nga themelimi i tyre. Kjo mund të jetë për shkak se nuk ka vetëdije publike për llojin e mbështetjes që ofrojnë këto shërbime, e as ndonjë fushatë kombëtare për format e ndryshme të dhunës seksuale që mund të përjetojnë gratë. Nuk ka qendra në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ofrojnë strehim të përkohshëm për viktimat e dhunës seksuale. Ekziston një qendër në Maqedoninë e Veriut që siguron strehim afatgjatë për viktimat e dhunës seksuale dhe mbështetje psiko-sociale, por kjo strehimore strehon gjithashtu edhe viktimat e trafikimit. Kjo strehimore ka një kapacitet prej 10 shtretërish. Qendra drejtohet nga OJQ Open Gate Macedonia (La Strada) që gjendet në Shkup. Strehimorja financohet pjesërisht nga shteti, ndërsa fondet tjera sigurohen nga donatorë të tjerë. Ata bashkëpunojnë ngushtë me institucionet përkatëse (Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministria për Punë të Brendshme) dhe kanë zhvilluar protokolle të brendshme për bashkëpunim dhe referime që nuk janë në dispozicion publik, sepse këto dokumente nuk janë të miratuara zyrtarisht.⁹² Nuk ekzistojnë kurrfarë shërbimesh tjera për dhunuesit apo viktimat e formave të ndryshme të dhunës seksuale, duke përfshirë përdhunimin. Një vendosje e tillë e shërbimit nuk mund të konsiderohet si mbrojtje e disponueshme dhe e qasshme e viktimave të dhunës seksuale dhe as si parandalim i duhur nga dhuna.

91 Rrjeti evropian Gratë kundër dhunës (WAVE), Hartëzimi i shërbimeve të dhunës seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 2019; në dispozicion në: https://cssplatform.org/wp-content/uploads/2019/10/CSSPWAVE_SVReport190927_web.pdf

92 Ibid.

MASA TË TJERA PARANDALUESE

Parandalimi dhe mbrojtja e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje është e mundur vetëm përmes një qasjeje *holistike* dhe bashkëpunimit dhe koordinimit midis palëve të interesit. Institucionet administrative publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, subjektet juridike nga sektori privat, partitë politike, mediat, shoqatat dhe fondacionet, grupet joformale, partnerët socialë, sindikatat, organizatat fetare dhe subjektet e tjera janë të detyruara të marrin masa parandaluese për të rritur ndërgjegjësimin për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke promovuar barazinë gjinore dhe duke eliminuar stereotipat e roleve gjinore që bazohen në kulturën, zakonet, fenë, traditat dhe praktikatat e tjera të bazuara në idenë e nënshtrimit të grave ndaj burrave.⁹³ Ata janë të detyruar të zbatojnë masa të përgjithshme parandaluese në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve, të mbledhin dhe publikojnë të dhëna dhe informacione të dobishme për parandalimin e dhunës, të sigurojnë koordinim të ndërsjellë në promovimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje si dhe të zbatojnë fushata për ngritjen e vetëdijes për shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj grave.

Sipas Planit për veprim, Qeveria, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, njësitë e vetëqeverisjes lokale në bashkëpunim me palët e tjera të interesit kanë detyrimin të realizojnë fushata kombëtare në media për të rritur ndërgjegjësimin për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore; për të promovuar barazinë gjinore dhe për të eliminuar stereotipat gjinore për rolet gjinore. Në përgatitje e sipër është një Strategji për komunikim që po realizohet me mbështetjen e Zyrës së UNFPA në Maqedoninë e Veriut, përmes një Projekti të financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo do të ndihmojë Qeverinë që të komunikojë informata me publikun dhe institucionet në mënyrë sistematike dhe të organizuar lidhur me njohjen dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje. Nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit publiku do të informohet mbi shërbimet që janë në dispozicion për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Një aspekt i rëndësishëm i parandalimit është krijimi i një sistemi për monitorim të situatës me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe krijimin e politikave dhe masave që do të jenë në përputhje me rezultatet e fituara. Sipas Konventës së Stambollit dhe LPMDhKFDhF, institucionet shtetërore janë të detyruara të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë së dhunuesit dhe viktimës, marrëdhënies midis dhunuesit dhe viktimës, vendndodhjes ku ka ndodhur dhuna, formës së dhunës dhe të dhënave të tjera që do të pasqyrojnë qartë situatën dhe do të informojnë publikun për përhapjen e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Në zhvillim e sipër është një sistem i integruar për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e këtyre llojeve të të dhënave.⁹⁴

93 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 24/2021. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje, neni 33.

94 Punëtori për planifikimin dhe unifikimin e të gjithë aktorëve kryesorë që punojnë në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut, 23 mars 2022, Shkup.

LPMDhKFDhF përcakton masat që duhet të ndërmerret çdo institucion dhe organizatë në përputhje me fushën përkatëse të punës. Në fushën e arsimit, Ministria për Arsim dhe Shkencë ka detyrimin të prezantojë përmbajtje në programet edukative që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen e konflikteve pa dhunë, respektimin e diversitetit, informim mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual në të gjitha fazat e arsimit, ndërsa Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në programet për institucionet parashkollore. Analiza të shumta tregojnë se tekstet shkollore dhe materialet mësimore që përdoren në të gjitha nivelet e arsimit kanë përmbajtje diskriminuese dhe ngacmuese që promovojnë dhe arsyetojnë dhunën ndaj grave. Është një kornizë përmes së cilës gjurmohen pikëpamjet e fëmijëve mbi rolet gjinore të grave dhe burrave, në familje dhe në bashkësi.⁹⁵ Të rinjtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut tregojnë pajtueshmëri të lartë me pikëpamjet tradicionale për rolin e grave (nënë, grua, eksperte) në familje.⁹⁶ Në këtë kontekst, arsimit duhet të luajë një rol kyç në sigurimin e një pengese të vazhdueshme për të gjitha llojet e pabarazisë, duke përfshirë këtu edhe barazinë gjinore. Në nuk mund të presim një shoqëri në të cilën respektohet barazia gjinore dhe në të cilën ka një prevalencë të vogël të dhunës me bazë gjinore, nëse këto vlera nuk janë të dukshme në arsim ose, nëse arsimit promovon stereotipat gjinore dhe idenë e inferioritetit të grave krahasuar me burrat. Ngjashëm është me përfaqësimin e grupeve të tjera në arsim dhe sidomos për identitetet interseksionale femërore, siç janë gratë me aftësi të kufizuara, romët, lezbiket, biseksualet, gratë transgjinore, gratë me ngjyrë, gratë nga pakicat etnike.⁹⁷ Plani për veprim për zbatimin e Konventës së Stambollit parasheh organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit dhe profesionistët nga arsimit fillor dhe i mesëm, edukatorët dhe kujdestarët në institucionet parashkollore, por deri në finalizimin e kësaj analize procesi i përgatitjes së moduleve për trajnimin bazë për parandalim nuk ka përfunduar. Sipas Planit Operativ për zbatimin e aktiviteteve nën kompetencën e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë për vitin 2019 në lidhje me Planin kombëtar për veprim për zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të Republikës së Maqedonisë, janë realizuar trajnime për mësimdhënësit nga pilot shkollat që kanë futur planprogram për edukim seksual gjithëpërfshirës.⁹⁸

Ministria e Drejtësisë në Planin e saj Operativ për vitin 2019 për zbatimin e Planit për veprim për zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të Republikës së Maqedonisë 2018-2023 nuk siguron zbatimin e masave të përgjithshme parandaluese, përveç politikave që kanë për synim të përafrojnë kornizën ligjore vendase me obligimet nga standardet ndërkombëtare

95 Simonovska S. Analizë mbi prezencën e stereotipeve gjinore në materialet arsimore në gjuhën maqedonase me rekomandime për vendimmarrësit, 2020. Në: <https://bit.ly/3uwMMRm> Analiza gjinore e teksteve shkollore në arsimin fillor. Padi në interesin publik për mbrojtje nga diskriminimi. Më shumë në: <https://akademik.mk/prva-tuzhba-protiv-uchebni-od-visoko-obrazovanie-vrz-osnova-na-noviot-zakon-zasprechuvane-i-zashtita-od-diskriminatsija/>

96 Kjostarova U.L. A KEMI FITUESIN? Pabarazitë gjinore në perspektivat shëndetësore dhe jetësore të adoleshentëve në Maqedoninë e Veriut, 2020, f. 27. Në dispozicion në: <https://bit.ly/34nYAKP>

97 Drndarevska D. Analiza e kornizës ligjore në fushën e arsimit në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna, me fokus në dhunën me bazë gjinore dhe diskriminimin në bazë të gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, 2021. Në dispozicion në: <https://bit.ly/30xeDNw>

98 Ministria për Arsim dhe Shkencë. Proceverbali nr. 1 03-124/1 nga 05.01.2022.

dhe rajonale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave. Në kontekstin e aktiviteteve parandaluese, është e rëndësishme të theksohen Ndryshimet në Rregulloren për Procedurën Gjyqësore të cilat do të sigurojnë një regjistër të veçantë të rasteve të dhunës ndaj grave në gjykata, të dhëna që do të shërbejnë për planifikimin e duhur të aktiviteteve dhe masave për parandalimin e dhunës.⁹⁹

Në momentin e realizimit të kësaj analize, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale po bënte hartimin e Planit Operativ për zbatimin e Planit kombëtar për veprim për Zbatimin e Konventës për parandalim dhe luftim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të Republikës së Maqedonisë për vitin 2022.¹⁰⁰ Deri në finalizimin e kësaj analize, Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë asnjë informatë për aktivitetet e zbatuara parandaluese në përputhje me Planin për veprim për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të Republikës së Maqedonisë 2018-2023.

Përveç masave të përgjithshme parandaluese, mediat kanë detyrimin të krijojnë dhe zbatojnë programe informuese dhe edukative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, për të promovuar barazinë gjinore dhe për të eliminuar stereotipat për rolet gjinore tradicionale. Detyrimi i shtetit është që të sigurojë që kultura, zakonet, feja dhe tradita nuk mund të jenë arsye për lloje të caktuara të dhunës dhe praktikave të dëmshme kundër grave. Sipas Planit për veprim për zbatimin e Konventës së Stambollit, është e nevojshme që të zhvillohen trajnime për përfaqësuesit e Këshillit të Etikës, Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-vizuale dhe profesionistëve të medias se si të raportojnë për çështjet që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore. Sipas informatave të marra nga MPPS, procesi i përgatitjes së moduleve për trajnimin bazik dhe të specializuar të profesionistëve në të gjitha institucionet që kanë për obligim të zbatojnë aktivitete për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave është në vazhdim e sipër dhe zbatohet me mbështetjen e donatorëve të huaj.¹⁰¹

Kishat, bashkësitë fetare dhe grupet fetare janë të detyruara të kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me ligjet, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ligji mund të kufizojë lirinë e shprehjes së fesë ose besimit, nëse është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve. LPMDhKFDhF është një dokument ligjor kombëtar që për herë të parë njih kishat, bashkësitë fetare dhe grupet fetare si partnerë në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe në të njëjtën kohë imponon një detyrim për t'u përmbajtur nga deklaratat ose njoftimet që arsyetojnë dhunën ndaj grave. Bashkësitë dhe grupet fetare luajnë një rol kyç në parandalimin e dhunës me bazë gjinore e cila arsyetohet si pjesë e kulturës, fesë ose traditës së një bashkësie, siç janë "vrasjet e nderit".

99 Ministria e Drejtësisë - Vendimi UP1 nr. 19-3143/2021.

100 Përgjigje në kërkesën për lirinë e informimit nr. 14-1576/5 nga 23.03.2022.

101 Punëtori për planifikimin dhe unifikimin e të gjithë aktorëve kryesorë që punojnë në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut, 23 mars 2022, Shkup.

TË DHËNA ADMINISTRATIVE PËR DHUNËN NË FAMILJE

LPMDhKFDhF mandaton të gjitha organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokurorinë publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, subjektet juridike që kryejnë administrim publik të përcaktuar me ligj si dhe shoqatat, të mbledhin të dhëna statistikore dhe administrative për situatën me dhunën me bazë gjinore (DhBGj) kundër grave dhe dhunës në familje, të bazuar në seksin, gjininë, moshën, përkatësinë në bashkësi, vendbanimin dhe të dhëna të tjera të përcaktuara nga Ligji kundër dhunës me bazë gjinore ose legjislacioni tjetër, në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.¹⁰²

LPMDhKFDhF i përcakton përgjegjësi të veçantë për mbledhjen e të dhënave gjykatave kombëtare dhe Prokurorisë Publike; ato duhet të krijojnë dhe mbajnë shënime për rastet e DhBGj dhe dhunës në familje¹⁰³, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas seksit dhe gjinisë¹⁰⁴.

LPMDhKFDhF parasheh gjithashtu përdorimin e përditshëm të një platforme kombëtare të ndërveprimit – Magjistralja Informative e Maqedonisë (MIM) nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale (MPPS) për shkarkimin e të dhënave të mbledhura.¹⁰⁵ Organet kompetente për mbledhjen e të dhënave që nuk janë përdorues të MIM-it kanë detyrimin të zhvillojnë shërbime në internet për shkëmbimin dhe transferimin e të dhënave të mbledhura për DhBGj si dhe të publikojnë të dhënat në faqet e tyre zyrtare.¹⁰⁶ Për më tepër, MPPS ka përgjegjësi të analizojë dhe përpunojë të dhënat e lartpërmendura në mënyrë statistikore në sistemin e saj për të drejtat dhe shërbimet sociale. Analizat dhe raportet që nuk përfshijnë të dhënat personale të mbrojtura me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të publikohen në baza vjetore nga MPPS.¹⁰⁷ Institucionet dhe organizatat e tjera përgjegjëse duhet gjithashtu të përpunojnë dhe publikojnë të dhënat e mbledhura në ueb faqet e tyre si dhe në Katalogun qendror për të dhëna nga sektori publik.¹⁰⁸

Përkundër detyrimit ligjor, shumica e institucioneve shtetërore nuk publikojnë rregullisht të dhënat e DhBGj ndërsa disave madje ju mungon mjedisi informatik që do t'u mundësojë atyre të regjistrojnë të

102 LPMDhKFDhF- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr.24/2021. Gjetet në: <https://bit.ly/2Uemjru>. Neni 11 parag.1, neni 24 dhe neni 28 parag.1.

103 Ibid. Art.29 dhe 30

104 Ligji DhBGj përmban përkufizime edhe për seksin dhe gjininë. Seksi përkufizohet si karakteristikat fizike të individit (sistemi riprodhues, kromozomet, hormonet) sipas të cilave seksi caktohet në lindje, bazuar në një kombinim të karakteristikave trupore dhe organeve të brendshme riprodhuese. Gjinia, sipas ligjit DhBGj, i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhetributeve të konstruara shoqërore, të cilat një shoqëri i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.

105 Ibid. Neni 28 parag.2.

106 Ibid. Neni 28 parag.3.

107 Ibid. Neni 28 parag.4.

108 Ibid. Neni 28 parag.5.

dhëna të ndara sipas gjinisë. MIM nuk është operativ¹⁰⁹ dhe ka indikacione se mungojnë të dhëna të besueshme dhe të përditësuara për DhBGj.¹¹⁰

Për të vlerësuar gjendjen aktuale, Kërkesat për Lirinë e Informacionit (KLI) u dërguan në institucionet përkatëse shtetërore që kanë një mandat për të mbledhur të dhëna për DhBGj ndërsa seksionet në vijim paraqesin të dhënat e marra.

MPPS - MINISTRIA PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

Siç përshkruhet më lart, MPPS është përgjegjëse për të analizuar të dhënat DhBGj brenda sistemit të saj për të drejtat dhe shërbimet sociale. Bazuar në të dhënat kumulative mbi raportet nga të gjitha QPS-të, në tre vitet e fundit mesatarisht ka 1564 viktima të regjistruara të DhBGj dhe DhF. Mesatarisht, 73% janë gra, 16% janë burra dhe 11% janë fëmijë.

Viktimat e DhBGj dhe DhF bazuar në numrin e raporteve për DhBGj dhe DhF tek QPS nga 2019 deri në 2021, të dhëna të marra nga MPPS




Figura 10. Viktimat e DhBGj dhe DhF bazuar në numrin e raporteve për DhBGj dhe DhF tek QPS nga 2019 deri në 2021, të dhëna të marra nga MPPS

Burim: Ministria për Punë dhe politikë sociale.

109 Platforma e Barazisë Gjinore (2022). Raporti në hije mbi zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Maqedoninë e Veriut
 110 Komisioni për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, vërejtje përmbyllëse mbi raportin e gjashtë periodik të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6 (14.11.2018)

Në vitin 2020 numri i përgjithshëm i viktimave ra për 1,5% ndërsa në vitin 2021 u rrit për 5%. Krahasimisht, janë vërejtur ndryshime të mëdha në numrin e fëmijëve të raportuar si viktimë të DhBGj dhe DhF - në vitin 2020 numri u ul për 30%, ndërsa në vitin 2021 u rrit për 78%.

Lloji më tipik i dhunës së raportuar është dhuna psikologjike, e cila mund të lidhet me faktin se dhuna psikologjike është shpesh e pranishme dhe e regjistruar si një shtesë për llojet e tjera të dhunës.

Numri i raporteve për DhBGj dhe DhF në QPS




Figura 11. Numri i raporteve për DhBGj dhe DhF, të ndara sipas llojit të dhunës. Të dhënat e marra nga MPPS.

Burim: Ministria për Punë dhe politikë sociale.

Mesatarisht 58% e dhunës së raportuar në QPS është psikologjike, 40% është fizike, 2% është ekonomike dhe 1% - dhunë seksuale. Sërish në vitin 2020, raportet kanë rënë për 18% për dhunën psikologjike, 41% për atë ekonomike dhe 55% për atë seksuale. Megjithatë, në vitin 2021, numrat u rritën përsëri. Nuk ka asnjë studim përfaqësues kombëtar që hulumton më tej shkaqet e këtyre luhatjeve dhe ndikimin eventuale të pandemisë me Covid-19, dhe nuk mund të nxjerrim asnjë konkluzion bazuar vetëm në këto të dhëna. Kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve të specializuara, shërbimi më i ofruar është mbështetja psiko-sociale (56% e shërbimeve të ofruara) dhe pasohet nga ndihma juridike (46% e shërbimeve të ofruara), ndërsa akomodimi në shërbime të specializuara shënon vetëm 3% të të gjitha shërbimeve të ofruara.





Figura 12. Shërbimet e ofruara për viktimat e DhBGj dhe DhF, të ndara sipas llojit. Të dhënat e marra nga MPPS

Për më tepër, gjatë tre viteve të fundit, gjithsej, 185 viktimat të DhF kanë përmbushur të drejtat e tyre financiare për mbrojtje sociale sipas Ligjit për mbrojtje sociale. Më saktësisht, 36 viktimat përmbushën të drejtën e tyre në 2019, 72 në 2020 dhe 71 në 2021.

MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME

Në përgjigjen zyrtare të Ministrisë për Punë të Brendshme thuhet se të dhënat e tyre janë të kufizuara për informata për dhunën në familje. Bazuar në të dhënat e marra, në periudhën trevjeçare nga viti 2019 deri në vitin 2021, ka një rekord të përgjithshëm prej 2996 viktimash të veprave penale të kryera në rrethana të rënda të dhunës në familje. Krimet që lidhen me dhunën në familje përfshijnë vrasje, përpjekje për vrasje, lëndime trupore, lëndime të rënda trupore, kërcënime ndaj sigurisë etj. Këto të dhëna sugjerojnë një rënie në vitin 2021 por duhet të merret parasysh se të dhënat për vitin 2021 nuk mbulojnë vitin e plotë (vetëm deri në shtator 2021). Pjesa më e madhe e krimeve të raportuara ka të bëjë me dëmtime të rënda trupore (neni 123) dhe kërcënime ndaj sigurisë (neni 144). Mesatarisht, 79% e të gjitha viktimave janë gra. MPB-ja nuk mblledh të dhëna të ndara sipas gjinisë për kryerësit e krimeve që kanë të bëjnë me DhF-në.

Vepra penale të kryera në rrethana të rënduara të dhunës në familje




*Të dhënat për vitin 2021 janë deri në muajin shtator

Figura 13. Viktimat e veprave penale të kryera në rrethana të rënda të dhunës në familje, të ndara sipas gjinisë, bazuar në numrin e raportimeve në MPB.

Veprat që lidhen me dhunën në familje përfshijnë ngacmimin e një personi tjetër në një apartament, sulmin fizik, pjesëmarrjen në një përlëshje, qortimin dhe bërtitjen në publik etj.

Vepra penale që lidhen me dhunën në familje



*Të dhënat për vitin 2021 janë deri në muajin shtator.

Figura13a. Shkelje që kanë të bëjnë me dhunën në familje, të ndara sipas gjinisë, në bazë të numrit të paraqitjeve në Ministrinë e punëve të brendshme.

Ndërsa për krimet që lidhen me DhF nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për dhunuesit, për shkeljet që kanë të bëjnë me DhF, MPB-ja ndau të dhënat si për dhunuesit ashtu edhe për viktimat. Në periudhën trevjeçare, janë regjistruar gjithsej 1429 viktima dhe 1414 kryerës të veprave penale që lidhen me dhunën në familje. Përsëri, rënia në vitin 2021 lidhet me faktin se të dhënat nuk mbulojnë vitin e plotë. Pjesa më e madhe midis veprave të regjistruara janë ngacmim i një tjetri në një apartament (neni 47) dhe sulmi fizik (neni 12). Për periudhën trevjeçare, gratë ishin mesatarisht 53% e viktimave ndërsa burrat janë 84% janë kryerës të dhunës.¹¹¹

111 Kjo mesatare 'trevjeçare' është një përafrim që nuk përfshin të dhëna nga tremujori i fundit i vitit 2021 (ato nuk ishin në dispozicion për t'u ndarë nga MPB në kohën e përfundimit të aktiviteteve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për këtë analizë).

GJYKATAT DHE PROKURORËT PUBLIK

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për gjykatat dhe prokuroritë publike, janë dërguar kërkesa për Liri të informacionit në të gjitha 27 gjykatat themelore dhe 22 prokuroritë publike. Përgjigjet janë marrë nga 24 gjykata (89%) dhe 11 prokurorë publikë (50%). Bazuar në të dhënat e 24 gjykatave themelore, në periudhën trevjeçare janë regjistruar gjithsej 1082 procedime penale, që çon në numrin 361 si mesatare vjetore.

Numri i procedurave të inicuar penale për dhunë familjare




Figura 14. Procedura penale në bazë të të dhënave të marra nga 24 gjykata themelore

Pjesa më e madhe e sanksioneve të dhëna janë dënime me kusht (64%), ndërsa në 18% paditësi ose ka hequr akuzën ose procedurat janë ndërprerë, në 13% sanksioni është burg, në 3% ka pasur një dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse (por nuk ka të dhëna specifike dhe as ndonjë sqarim nëse kjo përfshin një program për kryerësit), ndërsa në 2% dënimi ishte një gjobë financiare.

Shkelje që kanë të bëjnë me dhunën në familje




Figura 15. Procedurat civile bazuar në të dhënat e marra nga gjykatat themelore

Nga të dhënat e marra nga gjykatat themelore, mund të analizohet vetëm numri i përgjithshëm i procedurave të filluara për masa të përkohshme dhe urgjente për dhunën në familje - mesatarisht 482 në vit. Në 65% iniciatori është një QPS ndërsa MPB është iniciator në vetëm 8% të rasteve.

Raportimet për veprën penale të dhunës në familje




Figura 16. Procedura civile në bazë të të dhënave të marra nga 24 gjykata themelore

Të dhënat e marra nga prokuroritë publike tregojnë se mesatarisht regjistrohen 283 raporte, në vit, për dhunën në familje. Nga këto, 39% kanë rezultuar me refuzim ose mospranim të vendimit të prokurorisë, 34% kanë rezultuar me aktakuzë dhe 20% me urdhër dënimi, ndërsa në 5% të raporteve nuk është marrë asnjë vendim.

Paraqitje për vepër të kryer - dhunë në familje; viktima kundrejt kryerësve




Figura 17. Viktimat e DhF të ndara sipas gjinisë. Të dhëna nga 24 gjykata dhe 11 prokurori.

(Këtu nuk mund të përfshiheshin dy gjykatat më të mëdha në Shkup dhe Manastir!).

Gratë regjistrohen si viktima të DhF në 83% të të gjitha procedurave penale dhe ato përbëjnë 87% të të gjitha rasteve të procesuara brenda prokurorisë publike, ndërsa 78% e viktimave që kanë të bëjnë me procedurat civile janë gjithashtu gra. Nga ana tjetër, në 92% të procedimeve penale burrat paraqiten si autorë të DhF dhe burrat gjithashtu përbëjnë 91% kur bëhet fjalë për rastet e procesuara brenda prokurorisë publike dhe 90% në rastin e procedimeve civile.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe pse ekzistojnë **sisteme të vendosura të TI-së** për menaxhimin dhe administrimin e lëndëve për gjykatat dhe prokurorinë, sistemet **nuk janë përshtatur për regjistrimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.** Rrjedhimisht, të dhënat e ndara sipas gjinisë që ne arritëm të mbledhim u morën duke analizuar manualisht çdo skedar individual të lëndës si një kopje fizike. Kështu, dy gjykatat themelore me pjesën më të madhe të lëndëve (Gjykata Themelore Shkup dhe Manastir) nuk ishin në gjendje të përpunonin manualisht sasinë e madhe të të dhënave dhe këto nuk mund të mblidheshin.

KAPITULLI 3

HARTIMI I NEVOJAVE DHE BURIMEVE - ANKETË ME PALËT E INTERESIT

Për të hartuar nevojat dhe burimet për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, u realizua një anketë online me palët e interesit gjatë tremujorit të parë të vitit 2022. Sipas legjislacionit kombëtar dhe dokumenteve strategjike, sistemi i palëve përkatëse të interesit për parandalimin e dhunës me bazë gjinore është i gjerë dhe përfshin aktorë të ndryshëm shoqërorë. Kështu, një vegëz e pyetësorit të anketës, e disponueshme në maqedonisht dhe shqip, u shpërnda gjerësisht në ministritë kompetente dhe në institucionet dhe njësitë publike përkatëse kombëtare dhe rajonale, bazuar në regjistrat zyrtarë që ishin në dispozicion. Për më tepër, vegëza u nda edhe me organizatat relevante të shoqërisë civile dhe Platformën për Barazi Gjinore.

Në këtë anketë morën pjesë gjithsej 470 përfaqësues dhe 95% e tyre i përkasin institucioneve publike që janë pjesë e sistemit më të gjerë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, 3% janë përfaqësues të OShC-ve ndërsa 2% i përkasin sektorit privat.

Në anketë morën pjesë përfaqësues nga të gjitha ministritë përkatëse, ku Ministria e Drejtësisë ishte më pak e përfaqësuar në mesin e mostrës së institucioneve kombëtare. Në anketë morën pjesë gjithashtu edhe përfaqësues nga QPS, NJVL, institucionet shëndetësore, gjykatat themelore dhe prokuroria publike, policia dhe shkollat fillore dhe të mesme në nivel rajonal dhe lokal. Për fat të keq, përfaqësimi më i vogël mund të sigurohej nga policia, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të bëra për të rritur shkallën e përgjigjes nga këta profesionistë. Megjithatë, mund të jetë e mundur që ata të kenë identifikuar veten nën Ministrinë e Punëve të Brendshme. Institucionet arsimore dhe shëndetësore shënojnë përfaqësimin më të lartë në këtë anketë, përkatësisht 37% dhe 21% të të gjitha përgjigjeve.




Figura 18. Struktura e mostrës së anketës

Sa i përket moshës, më shumë se dy të tretat e të anketuarve janë midis 35 dhe 54 vjeç, më konkretisht, 39% i përkasin grup moshës 35-44 vjeç dhe 30% janë 45 deri në 54 vjeç. Struktura e mostrës në aspektin e arsimit nënkupton se dy prej tre kanë diplomë universitare si nivel më i lartë i arsimit, ndërsa çdo i katërti ka një diplomë magjistrature. Përfaqësuesit me arsim të mesëm përbëjnë rreth 6% ndërsa 3% janë me diplomë doktorature. Gati gjysma, pra 48% e pjesëmarrësve, jetojnë dhe punojnë në rajonin e Shkupit, ndërsa 10% jetojnë dhe punojnë në pjesën lindore të vendit dhe e njëjta përqindje është regjistruar për rajonin juglindor të Maqedonisë së Veriut. Pjesa tjetër e rajoneve statistikore janë të përfaqësuar me më pak se 10% në mostrën e përgjithshme.

QËNDRIMET NDAJ BARAZISË GJINORE DHE KËSHILLIMIN E DHUNUESVE

Për të vlerësuar qëndrimet ndaj barazisë gjinore dhe roleve gjinore, është paraqitur një listë me deklarata ndërsa iu kërkua përfaqësuesve të shprehnin mendimin e tyre për secilën deklaratë të listuar në një shkallë nga 1-5 (ku 1 do të thotë nuk pajtohem aspak; ndërsa 5 pajtohem plotësisht). Në tabelën më poshtë është paraqitur shpërndarja e pjesëmarrësve, bazuar në nivelin e pajtimit dhe mesataren si masa për tendencën qendrore që tregon se cili është niveli “mesatar” i pajtimit në mostrën. Duke pasur parasysh se deklaratat e renditura pasqyrojnë disa nga qëndrimet patriarkale ndaj roleve gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, **është inkurajuese që për shumicën e deklaratave mesatarja është ose 2 ose 1, që implikon një mospajtim më të fortë me deklaratën.** Megjithatë, **është alarmante që gjysma e pjesëmarrësve nuk po e kundërshtojnë qëndrimin e pasqyruar në deklaratë: “Disa gra janë manipuluese dhe provokojnë zemërim dhe dhunë nga partnerët e tyre”.** Kjo është shqetësuese sepse deklarata nënkupton një **perspektivë për fajësim të viktimës ndaj dhunës me bazë gjinore dhe arsyetimit të dhunës me bazë gjinore.** Në mënyrë të ngjashme, **çdo i katërti pajtohet dhe çdo i pesti është i rezervuar ndaj deklaratës: “Një grua tregon respekt për burrin e saj kur kujdeset për fëmijët ose të moshuarit”, gjë që nënkupton dhe konfirmon përfaqësimin e gjerë të supozuar të perspektivave tradicionale të roleve gjinore.**

Tabela 1. Qëndrimet ndaj barazisë gjinore - shpërndarja e përgjigjeve dhe masat e tendencës qendrore

	Nuk pajtohem aspak 1	Nuk pajtohem 2	Pajtohem 4	Pajtohem plotësisht 5	- (1+2)	As pajtohem e as nuk pajtohem. 3	+ (4+5)	Mesatarja
Disa gra janë manipuluese dhe provokojnë zemërim dhe dhunë nga partnerët e tyre.	25%	25%	20%	3%	50%	27%	23%	3
Një grua tregon respekt për burrin e saj kur ajo kujdeset për fëmijët ose të moshuarit.	26%	27%	20%	6%	53%	21%	26%	2
Gratë natyrisht kanë nevojë për mbrojtje nga burrat.	26%	37%	16%	4%	63%	17%	20%	2
Është e natyrshme që gratë të jenë më emocionale dhe të nënshtuara ndërsa burrat të jenë më të ashpër dhe dominues. Ne do të donim të dëgjonim mendimet tuaja për disa çështje.	37%	35%	9%	3%	72%	16%	12%	2
Burri dhe gruaja duhet të përpiqen të pajtohen për hir të fëmijëve edhe kur ka pasur incidente të herëpashershme të dhunës.	38%	35%	12%	3%	73%	12%	16%	2
Nëse një grua është e veshur në mënyrë provokative, është normale që burrat t'i fishkëllejnë ose t'i hedhin fjalë.	41%	34%	9%	3%	75%	13%	12%	2
Gratë e teprojnë kur thonë se kanë vuajtur "dhunë psikologjike".	34%	42%	6%	2%	76%	16%	8%	2
Vetëm nënat duhet të marrin pushim për lindje, është e panatyrshme që burrat të marrin muaj nga puna për pushim prindëror.	39%	38%	8%	2%	77%	12%	11%	2
Idetë e reja rreth meshkujve të butë dhe emocionale i bëjnë djemtë e rinj homoseksuale.	41%	38%	3%	3%	79%	15%	6%	2
Është normale që babai ta disiplinojë fëmijën duke e goditur herë pas here me shuplakë.	49%	37%	5%	1%	86%	8%	5%	2

	Nuk pajtohem aspak 1	Nuk pajtohem 2	Pajtohem 4	Pajtohem plotësisht 5	- (1+2)	As pajtohem e as nuk pajtohem. 3	+ (4+5)	Mesatarja
Edhe kur mendimi i saj është i ndryshëm, është një formë mos respekti nëse gruaja nuk pajtohet me vendimin e burrit të saj.	54%	36%	3%	1%	90%	6%	5%	1
Është e natyrshme që burrat të jenë furnizuesit ndërsa gratë të jenë të përkushtuara ndaj familjes.	63%	28%	3%	1%	91%	6%	4%	1
Dhuna në familje është një çështje private.	65%	29%	1%	1%	94%	4%	2%	1
Nuk është e pazakontë që një burrë të godasë gruan e tij në një gjendje afekti.	83%	14%	1%	1%	97%	1%	2%	1
Është e turpshme nëse gruaja fiton më shumë para se burri.	80%	17%	0%	1%	97%	1%	1%	1

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022)

U vlerësuan gjithashtu **qëndrimet ndaj programeve për trajtimin e dhunuesve**. Lista e deklaratave ishte e balancuar, gjysma reflektonte një qëndrim pozitiv ndërsa gjysma tjetër reflektonte një qëndrim negativ. Përsëri, **është inkurajuese që shumica e pjesëmarrësve u pajtuan me deklaratat që pasqyronin qëndrimin pozitiv për programet për trajtim të dhunuesve**. Megjithatë, duhet të theksohet se vetëm 38% nuk u pajtuan me deklaratën “Dhunuesit do të keqpërdorin programet për trajtim psiko-social për të lehtësuar dënimin” duke nënkuptuar se **një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve ose hezitojnë ose pajtohen me deklaratën**. Në mënyrë të ngjashme, gjysma e pjesëmarrësve nuk e kundërshtuan deklaratën “Programet për punë me dhunuesit u japin atyre një përparësi në sistemin e drejtësisë ose u ndihmojnë që ata të fshehin më mirë dhe të arsyetojnë sjelljet e tyre abuzive”, gjë që përsëri **mund të sugjerojë një shqetësim se këto lloj programesh mund të keqpërdoren**.

Tabela 2. Qëndrimet ndaj këshillimit të dhunuesve - shpërndarja e përgjigjeve dhe masat e tendencës qendrore

	Nuk pajtohem aspak 1	Nuk pajtohem 2	Pajtohem 4	Pajtohem plotësisht 5	- (1+2)	As pajtohem e as nuk pajtohem. 3	+ (4+5)	Mesatarja
Programet për trajtimin psiko-social të autorëve të krimeve u ndihmojnë atyre që të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre	2%	4%	65%	14%	6%	15%	79%	4
Programet për punë me dhunuesit rrisin sigurinë dhe mirëqenien për gratë dhe fëmijët	1%	4%	60%	17%	5%	17%	78%	4
Programet për punë me dhunuesit i ndihmojnë ata që të zhvillojnë një metodë më të sigurtë dhe pozitive prindërimi.	1%	3%	63%	12%	4%	21%	75%	4
Programet për punë me dhunuesit rrisin aftësitë për vetë-reflektim të burrave, duke i mbështetur ata që të zhvillojnë strategji përballimi që nuk janë të dhunshme	1%	3%	57%	15%	4%	24%	72%	4
Dhunuesit do të keqpërdorin programet për trajtim psiko-social për të lehtësuar dënimin	9%	29%	22%	4%	38%	36%	26%	3
Programet për punë me dhunuesit u japin atyre një përparësi në sistemin e drejtësisë ose u ndihmojnë atyre që të fshehin më mirë dhe të arsyetojnë sjelljet e tyre abuzive.	8%	40%	13%	3%	48%	36%	16%	3
Investimi në shërbime për punë me dhunuesit është si "vjedhja" nga fondet për përkrahje të viktimave	19%	47%	8%	2%	66%	24%	10%	2
Shërbimet e trajtimit psiko-social për autorët e krimit janë një humbje kohe dhe parash, sepse sjellja e dhunshme nuk mund të ndryshohet.	31%	47%	5%	2%	77%	16%	6%	2


Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022)

TRAJNIME PËR PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Plani për veprim për zbatimin e Konventës parashikon trajnime për mësuesit dhe asistentët e shkollave fillore dhe të mesme, edukatorët dhe kujdestarët, profesionistët e QPS-ve, policët, profesionistët e shëndetësisë, gjyqtarët dhe prokurorët publikë, ekspertët mjeko-ligjorë, përfaqësuesit e zyrave rajonale për ndihmë juridike falas dhe organet lokale për mundësi të barabarta në NJVL dhe personat përgjegjës për mbrojtje sociale brenda NJVL-ve.

Nga të gjithë pjesëmarrësit e anketuar, më shumë se gjysma nuk kanë pasur kurrë ndonjë trajnim për parandalimin e DhBGj ndërsa 12% të tjerë nuk mbajnë mend nëse kanë pasur ndonjëherë. Pak më shumë se një e treta (36%) kanë pasur trajnim për parandalim të dhunës me bazë gjinore ndërsa shumica e tyre (68%) kanë pasur një trajnim të tillë në pesë vitet e fundit.

Pyetje: A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë trajnim për parandalimin e DhBGj?



Pyetje: A keni marrë pjesë në trajnime për parandalimin e DhBGJ në PESË VITET E FUNDIT?




Figura 19. Pjesëmarrësit që kanë pasur trajnim për parandalimin e DhBGj.

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 dhe përkatësisht 169 të anketuar, 2022)

Të anketuarit që raportuan se kishin pasur trajnime në pesë vitet e fundit u pyetën më tej për organizatorët e trajnimit dhe **gati gjysma e tyre u përgjigjën se një OShC ka realizuar trajnimet.**

Pyetje: Kush ka organizuar trajnimin që keni marrë për parandalimin e DhBGj?




Figura 20. Përgjigje të pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në trajnim për DhBGj në pesë vitet e fundit (n=115 të anketuar), për atë se kush e ka organizuar trajnimin (me theks në trajnimin e fundit, nëse ka pasur më shumë se një).

Burim: hulumtim në internet i Reactor (2022).

Shumica e trajnimeve nuk ishin të detyrueshme dhe 67% e pjesëmarrësve u përgjigjën se pjesëmarrja e tyre ka qenë vullnetare. Çdo i pesti i anketuar (22%) ka marrë pjesë në një trajnim të detyrueshëm, ndërsa 11% nuk e mbajnë mend natyrën e trajnimit që kanë pasur. Më shumë se gjysma (54%) u përgjigjën se nuk janë të vetëdijshëm nëse organizatorët matën ndonjë ndryshim në qëndrimet ose/dhe sjelljen e pjesëmarrësve pas trajnimit, ndërsa **më shumë se një e treta (35%) konfirmuan se vlerësimet e tilla ishin të integruara në trajnim.** Kur u pyetën për të vlerësuar cilësinë e trajnimit për parandalimin e DhBGj që kishin, **shumica e pjesëmarrësve vlerësuan trajnimin si të mirë (42%) ose shumë të mirë (36%),** ndërsa çdo i pesti (22%) dha një vlerësim më të rezervuar për trajnimin (dmth. me cilësi të pranueshme, por as të mirë as shumë të mirë) ndërsa 1% vlerësuan trajnimet e tyre si shumë të dobëta.

MOBILIZIMI PËR PARANDALIM TË DHBGJ

Pjesëmarrësve iu kërkua gjithashtu të ndajnë mendimin e tyre **se cila do të ishte mënyra më efektive për të angazhuar burrat dhe djemtë në parandalimin e DhBGj në vendin tonë**. Bazuar në përgjigjet e tyre, **krijimi i qendrave të specializuara për mbështetje psiko-sociale falas (për prindërim, marrëdhënie, kujdes për veten) njihet si mënyra më efektive** me 67% të pjesëmarrësve që pajtohen me këtë deklaratë të parapërcaktuar. Për më tepër, **60% u përgjigjën se krijimi i linjave të ndihmës S.O.S. për burrat dhe djemtë do të ishte një alternativë efektive** dhe **56% besojnë se angazhimi i OShC-ve për të punuar me të rinjtë do të ishte një mënyrë efektive**.

Pyetje: Deri në çfarë mase mund të jetë efektive secila nga mënyrat e mëposhtme për të angazhuar burrat dhe djemtë në parandalimin e DhBGj në vendin tonë?




Figura 21. Mënyrat për të angazhuar burrat dhe djemtë në parandalimin e DhBGj të vlerësuara për efektivitetin e tyre.

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022).

Shumica e të anketuarve besojnë se institucionet arsimore dhe mediat duhet të përfshihen më shumë në parandalimin e DhBGj. Gjysma ose gati gjysma mendojnë se **profesionistët e shëndetësisë, OShC-të dhe organizatat rinore duhet të përfshihen më shumë në parandalimin e DhBGj.** Vetëm një e dhjeta ose më pak mendojnë se zyrtarët e lartë shtetërorë, sindikatat dhe kompanitë private duhet të përfshihen më shumë në parandalimin e DhBGj. Për shkak të natyrës së anketës në internet, mbetet e hapur nëse pjesëmarrësit nuk e njohën rolin e këtyre palëve të interesit në parandalimin e DhBGj ose mendojnë se përfshirja e tyre nuk do të ishte efektive.

Çfarë mendoni, cilët aktorë duhet të përfshihen më shumë në parandalimin e DhBGj?




Figura 22. Aktorët socialë që duhet të përfshihen më shumë në parandalimin e DhBGj, bazuar në perceptimet e pjesëmarrësve.

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022).

SHËRBIME TË SPECIALIZUARA PËR KRYERËSIT E DHBGJ

Shumica dërrmuese e të anketuarve në internet, d.m.th. 86%, pajtohen se vendit tonë i mungojnë shërbimet e specializuara (pastrimi psiko-social, këshillimi, terapia, trajnimi, trajtimi) për kryerësit e DHBGj.

Pjesëmarrësit në diskutimet cilësore të fokus-grupeve më tej vërejnë se ka vetëm një qendër funksionale që ofron shërbime për autorët e krimin për të gjithë vendin. Disa prej tyre besojnë se **Ministria e Shëndetësisë duhet të jetë përgjegjëse për zhvillimin e qendrave të tilla dhe konsiderojnë se ky shërbim duhet të bie nën sferën e shëndetit publik. Ekziston edhe çështja e mungesës së angazhimit të policisë në rastet kur është i nevojshëm largimi i dhunuesit nga shtëpia.**¹¹²

Një përfaqësues nga Instituti për Çështje Sociale vuri në dukje rëndësinë e ekzistencës së standardeve dhe procedurave të zhvilluara kohët e fundit (SP) duke përfshirë standardet dhe procedurat për punën e një qendre këshillimi dhe trajtimin psiko-social të kryesve të DHBGj dhe DhF. Përveç kësaj, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përmendi qendrat e këshillimit për trajtimin psiko-social të dhunuesve që janë të hapura në dhjetë lokacione në vend si pjesë e njësisë lokale të Qendrave për Punë Sociale, por në lokacione të ndara, ndërsa dhunuesit pritet të realizojnë 20 takime këshilluese – katër individuale dhe gjashtëmbëdhjetë si pjesë e një këshillimi në grup me dhunues të tjerë.

“Pas ratifikimit të Konventës së Stambollit, kemi hapur qendra këshillimi për trajtim psiko-social të autorëve të DHBGj. Këto janë pjesë e Qendrave lokale për Punë Sociale, por janë të vendosura fizikisht në një ndërtesë të veçantë. E njëjta zyrë përdoret edhe për këshillimin e viktimave, por terminet bëhen në ditë të ndryshme në mënyrë që të shmangim incidentet. Njerëzit që punojnë me viktimat janë të tjerë nga ata që punojnë me dhunuesit” – thotë një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet këtu se Raporti më i fundit në Hije nga Monitorimi i zbatimit të Planit për veprim për zbatimin e Konventës së Stambollit zbulon se këto SP i referohen hapësirës, pajisjeve dhe personelit dhe procedurave për referim, pritje dhe vlerësim, ndërsa mungojnë ende standardet për një program të dedikuar për punë me kryerësit e DHBGj dhe DhF.¹¹³

Programet për kryerësit e DHBGj janë të dizajnuara në një mënyrë që kërkon që kryerësi të ketë një kapacitet për arsyetim konjitiv për të qenë në gjendje të arrijë qëllimin e marrjes së përgjegjësisë dhe të

112 Diskutimet dhe intervistat e FG me OShC-të dhe aktorët e tjerë të realizuara nga Reactor midis dhjetorit 2021 dhe shkurtit 2022.

113 Karovska Čemerska, D. HERA (2022). Raport mbi monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. I disponueshëm në: <https://hera.org.mk/izveshtaj-monitoring-ap-istanbulska-konvencija/>

punojë drejt ndryshimit të sjelljes. Megjithatë, theksohet gjithashtu se sistemi i shoh këto programe si 'një lehtësim për përgjegjësinë penale'.

"Nëse nuk vlerësohet mirë nëse një person i caktuar mund të jetë pjesë e programit, nuk arrihet qëllimi i pranimi të përgjegjësisë, as nuk arrihet qëllimi përfundimtar i ndryshimit të sjelljes së kryerësit." - thotë një përfaqësues nga OShC- ofrues i shërbimit.

Profesionistët që kanë përvojë pune në një qendër të ofrimit të shërbimeve për autorët e DhBGj vërejnë se pavarësisht progresit të pretenduar në raportin zyrtar të vendit, realiteti nuk është aq i ndritshëm dhe vetëm një pjesë e vogël e dhunuesve e kanë përfunduar programin nga fillimi deri në fund.

"Kur kam punuar në HERA, kemi bashkëpunuar me QPS, QPS na i referonte dhunuesit me një referim. Asnjë nga dhunuesit që kam parë nuk ka kaluar nëpër të gjitha fazat e programit për dhunuesit. Në raportet për shtetin është shënuar përparim, përmendet se ka qendra këshillimi, por në praktikë ato nuk funksionojnë e as kanë kapacitet për t'u marrë me dhunuesit dhe njëkohësisht sigurojnë një qasje të sigurisë së viktimave " - thotë një përfaqësues nga OShC – ofrues i shërbimit.

Pyetje: A mendoni se vendit tonë i mungojnë shërbimet e specializuara (pastrimi psiko-social, këshillimi, terapia, trajnimi, trajtimi) për kryerësit e DhBGj?




Figura 23. Perceptimet për disponueshmërinë e shërbimeve të specializuara për kryerësit e DhBGj.

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022)

Të anketuarit e anketës në internet të cilët u përgjigjën se kemi mungesë të shërbimeve të specializuara për dhunuesit u pyetën më tej për arsyet kryesore për mendimin e këtillë të tyre dhe më shumë se gjysma e tyre, **si një faktor i rëndësishëm, përmendën mungesën e profesionistëve të trajnuar për të punuar me dhunuesit**, ndërsa çdo i treti vuri në pah **mungesën e moduleve gjithëpërfshirëse për të trajnuar profesionistët që duhet të punojnë me dhunuesit**. Për më tepër, 40% e këtyre të anketuarve zgjodhën **mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit multisektorial si një faktor kontribues**.

Pyetje: Pse kemi mungesë të shërbimeve të specializuara (pastrim psikosocial, këshillim, terapi, trajnim, trajtim) për kryerësit e DhBGj?




Figura 24. Faktorët identifikues që nënvizojnë mungesën e shërbimeve të specializuara për kryerësit e DhBGj.

Burim: Hulumtim në internet i Reactor (470 të anketuar, 2022).

Një shumicë e madhe e të anketuarve të intervistuar në internet (mbi 80%) pajtohen se për të mundur dhe përmirësuar qasjen në shërbime të specializuara (pastrim psiko-social, këshillim, terapi, trajnim, trajtim) për kryerësit e DhBGj ekzistojnë disa çështje thelbësore që duhet të adresohen: trajnimi i duhur i profesionistëve që do të ofrojnë shërbimet (87%), financim i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm për t’u krijuar dhe funksionuar shërbimet e tilla (83%) dhe informimi i bashkësive për disponueshmërinë e shërbimit (83%). Për më tepër, **shumica gjithashtu beson se bashkëpunimi i ngushtë me shërbimet mbështetëse të grave (83%) do të ishte vendimtare që këto shërbime të funksiononin**.

Pyetje: Bazuar në mendimin tuaj, deri në çfarë mase është e rëndësishme secila nga gjërat në vijim për të mundësuar dhe përmirësuar qasjen për shërbime të specializuara (pastrim psiko-social, këshillim, terapi, trajnim, trajtim) për kryerësit e DhBGJ?




Figura 25. Identifikimi i faktorëve që mund të kenë qasje të mëtejme për shërbime të specializuara për kryerësit e DhBGj.

SHËRBIME TË SPECIALIZUARA PËR VIKTIMAT DHBGJ¹¹⁴

Sipas informatave të mbledhura nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, qendrat e strehimit dhe shërbimet e specializuara të kujdesit për DhBGj rregullohen me standarde dhe procedura të veçanta. Sipas të njëjtit informacion MPPS, ekzistojnë qendra këshillimi në 10 QPS të ndryshme që punojnë me viktimat dhe kryerësit e DhBGj, të vendosura në një ndërtesë të veçantë nga ajo e QPS dhe ata kanë ekipe të veçanta, dmth., të punësuarit e tyre.

Përveç këtyre, Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për tre qendra të tjera për ofrimin e kujdesit shëndetësor për viktimat e DhBGj. Plani strategjik fillestar ka parashikuar të ketë të paktën gjashtë qendra të tilla, por për shkak të financimit të pamjaftueshëm vetëm tre ishin funksionale dhe me qendër në

114 Diskutimet cilësore të fokus grupeve dhe intervistat me OShC-të dhe aktorët e tjerë të kryera nga Reaktor-i midis dhjetorit 2021 dhe shkurtit 2022 janë burimi kryesor i informacionit dhe sqarimeve pas këtij seksioni tematik.

Shkup, Kumanovë dhe Tetovë. Megjithatë, përveç sfidave të tjera praktike, gjatë pandemisë me Covid-19 këto qendra u ristrukturuan në qendra për Covid-19 dhe nuk ishin aspak të qasshme për viktimat e DhBGj.

“Qendrat ende nuk janë të pajisura mirë. Përveç kësaj, ne duhet të bashkëpunojmë me OShC-të grave që ofrojnë kujdes për viktimat e DhBGj dhe të përdorim mbështetjen e tyre. Ende mungojnë financimi i duhur dhe koordinimi më i mirë. Shërbimet janë plotësisht falas, ndërsa viktimat nuk ka nevojë të sigurojë ndonjë dokument identifikimi personal – por qasja e tyre ishte plotësisht e kufizuar gjatë pandemisë dhe qendrat u shndërruan në qendra trajtimi për Covid-19. – tha një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë.

Një përfaqësues nga Instituti për Çështje Sociale vuri në dukje edhe një herë standardet dhe procedurat e miratuara kohët e fundit duke përfshirë SP për: Punën e QPS me viktimat e DhBGj dhe dhunës në familje, shërbime të specializuara për strehimin e viktimave, shërbime të specializuara për këshillimin e grave viktimat të DhBGj dhe shërbim të specializuar të ofrimit të linjave SOS për viktimat e DhBGj dhe dhunës në familje. Megjithatë, efikasiteti dhe eficaenca e procedurave nuk mund të vlerësohen pasi shumica e personelit të përfshirë nuk ka marrë ende trajnimin e duhur. Përveç kësaj, sfidat në kryeqytet duket të jenë më komplekse se ato në qytetet tjera.

Sfida më e vështirë është në Shkup ku kemi fluktuimin më të madh të profesionistëve. Është shumë herët për të bërë një vlerësim ende, por është fakt se QPS e Shkupit është më e madhja, me probleme shumë komplekse dhe profesionistë që nuk kanë kapacitet për të zgjidhur çështjet në një mënyrë që ne do t’ua preferonim – tha një përfaqësues nga Instituti për Çështje Sociale.

Për më tepër, një përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme thekson rëndësinë e një sistemi të unifikuar për mbledhjen e të dhënave në rastet e DhBGj dhe DhF për të gjitha institucionet kombëtare. Megjithatë, çështja më akute që kërkon veprim urgjent është që nëpunësit e policisë të trajnohen për trajtimin e rasteve të DhBGj në mënyrë të ndjeshme gjinore dhe përmirësimin e departamentit aktual të nëpunësit e policisë që punojnë me dhunën në familje.

“Trajnimet janë vendimtare si për parandalimin ashtu edhe për përmirësimin e mbrojtjes nga DhBGj. Ekziston një departament i posaçëm policor për dhunën në familje që është jashtëzakonisht me pak të punësuar, kryesisht për shkak të praktikave të këqija të menaxhimit. Departamenti duhet të rritet, ndërsa të gjithë duhet të trajnohen për këtë temë” – tha një përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjetjet gjithashtu zbulojnë se është zhvilluar një metodologji e veçantë nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në lidhje me liçencimin e shërbimeve për viktimat e DhBGj, por sipas OShC-ve të përfshira në

këtë proces, kjo metodologji është e papërshtatshme dhe nuk plotëson kërkesat kryesore që sigurojnë qëndrueshmërinë e këtyre shërbimeve. Njëra nga sfidat kryesore të theksuara është se kjo metodologji parasheh financim (të pamjaftueshëm) për një shërbim të vetëm të kryer, i cili implikon se qendrat mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë qëndrueshmërinë në rast të kërkesës së ultë për shërbimet e tyre gjatë një periudhe të caktuar. Në mënyrë plotësuese, fondet e parapara nga MPPS mbulojnë pjesërisht harxhimet për angazhim të një psikologu dhe një punëtori social, por dështojnë në përfshirjen e çfarëdo harxhimeve për këshillim në karrierë dhe ndihmë juridike. OShC-të konfirmojnë se janë konsultuar gjatë procesit të zhvillimit të kësaj metodologjie, por ata gjithashtu vërejnë se sugjerimet e tyre nuk janë marrë parasysh.

“Nëse nuk kemi shërbime të mjaftueshme që ofrohen, nuk do të ketë mjaft fonde as edhe për shpenzimet e përgjithshme dhe nuk do të jetë e mundur të sigurohen fonde për pagat dhe kontributet për të punësuarit. - përfaqësues nga një OShC - ofrues i shërbimit.

“Mbështetja e specializuar është një formë e rëndësishme e parandalimit të dhunës së ardhme, shërbimet e specializuara duhet të ekzistojnë dhe të financohen siç duhet dhe mjaftueshëm nga shteti” – një përfaqësues nga një OShC – ofrues i shërbimit.

Sipas MPPS, aktualisht ekzistojnë tetë qendra që punojnë me viktimat të DhBF dhe vetëm një që punon gjithashtu edhe me dhunuesit.

Një nga çështjet kryesore në themelimin e qendrave të tilla është pasiguria mbi përgjegjësinë për financim dhe menaxhim të këtyre shërbimeve. Më konkretisht, profesionistët e konsultuar besojnë se duhet të emërohet një ministri e vetme si përgjegjëse për gjithë menaxhimin e shërbimeve të tilla që të ketë një mbikëqyrje më të lehtë të të gjitha proceseve dhe për të koordinuar aktorët e ndryshëm në këtë fushë.

“Duhet të ketë një ministri kompetente që do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e tyre, krijimin e standardeve, procedurave të punës, licencimin e personave që do të ofrojnë shërbimet dhe punësimin e personelit të kualifikuar. - përfaqësues nga OShC - ofrues i shërbimit.

Edhe më shumë, siç konfirmon¹¹⁵ edhe Raporti i fundit në hije, ende nuk ka një protokoll zyrtar për trajtimin shumë-sektorial të viktimave të DhBGJ dhe ndërlihdjen me shërbimet tjera si dhe standardet dhe procedurat për ndihmë juridike falas për viktimat e DhBGJ dhe informimin e viktimave për ankesat individuale dhe kolektive në organet rajonale dhe ndërkombëtare. Ky raport ri-konfirmon më tej se ndihma

115 Karovska Çemerska, D. HERA (2022). Raport mbi monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. I disponueshëm në: <https://hera.org.mk/izveshtaj-monitoring-ap-istanbulska-konvencija/>

juridike falas është në dispozicion të viktimave të DhBGj dhe DhF në përputhje me Ligjin për ndihmë juridike falas, sipas të cilit nuk kërkohet një shqyrtim i gjendjes së tyre financiare si parakusht për përdorimin e kësaj ndihme.¹¹⁶

Të gjitha palët e konsultuara dhe palët e interesit bien dakord që duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë trajnimeve që duhet mbajtur për profesionistët. Aktualisht, nuk ka informata shtesë mbi përmbajtjen dhe menaxhimin formal të këtyre trajnimeve. Ka indikacione se modulet e zhvilluara për Policinë janë me cilësi së pranueshme, por qasja që marrin nëpunësit e policisë gjatë interpretimit të përmbajtjes është problematike.

Të gjitha stereotipat e njohura përsëriten përmes trajnimit të nëpunësve të policisë – thotë një përfaqësues nga një OShC - ofruer i shërbimit.

Ka shumë hapësirë 'gri' që duhet të hulumtohet më tej kur bëhet fjalë për trajnime me profesionistë për shkak të mungesës së një qasjeje sistematike më universale ndaj temës si dhe transparencës dhe sistematizimit të të dhënave. Megjithatë, të gjitha palët e konsultuara pajtohen se ka shumë hapësirë për përmirësime dhe këto përmirësime duhet të jenë të natyrës së menjëhershme dhe sistematike.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Programet për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje synojnë të parandalojnë dhunën ndaj grave, të rrisin sigurinë e viktimave të dhunës në familje, por në të njëjtën kohë të kontribuojnë në procesin e transformimit politik dhe kulturor të shoqërisë dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit me bazë gjinore.

Analiza e kornizës ligjore dhe krahasimi me standardet ndërkombëtare dhe rajonale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje tregojnë pajtueshmëri të konsiderueshme të kornizës ligjore me Konventën e Stambollit dhe ekzistencën e një baze ligjore për krijimin dhe menaxhimin e programeve për trajtimin e kryerësve të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Standardet dhe procedurat për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve të tilla, nga ana tjetër, nuk janë plotësisht në përputhje me Konventën e Stambollit dhe Ligjin për parandalim dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje dhe ato janë të reduktuara vetëm për të shërbyer kryerësit e dhunës në familje.

¹¹⁶ Ibid.

Autoritetet pretendojnë se ekzistojnë tetë qendra këshillimi të krijuara për trajtimin psiko-social të autorëve të dhunës në familje, por ka mungesë të plotë informacioni mbi përshtatshmërinë e vendndodhjes, kushtet hapësinore, kapacitetet e personelit që punon me dhunuesit, efektivitetin e programeve dhe përafrimin dhe korelacionin e tyre me shërbimet e tjera të ofruara nga institucionet dhe organizatat në nivel kombëtar dhe lokal. Ekziston një mungesë e plotë e një programi për të trajtuar kryerësit e dhunës seksuale.

Mungesa e mbështetjes për viktimat që raportojnë dhunën çon në një numër të reduktuar të rasteve që ndiqen penalisht në krahasim me numrin e rasteve paraprake të raportuara të dhunës. Analiza gjithashtu tregon një numër të ulët të masave të përkohshme mbrojtëse të caktuara për këshillim të detyrueshëm të dhunuesit. Nevojitet analizë e mëtejshme për të shqyrtuar arsyet pas kësaj tendence dhe për të zbuluar nëse gjykatat nuk janë të prirura për të caktuar këto masa, ose nëse kapacitetet e kufizuara të QPS, të cilat kanë të drejtën të ofrojnë këtë lloj këshillimi, janë një pengesë dhe ndikojnë negativisht në zbatimin efektiv të masës mbrojtëse.

Ekziston një pengesë shtesë në proces për shkak të mungesës së një protokollit me shkrim ose udhëzimeve për të ndihmuar profesionistët në trajtimin e kryerësve të dhunës që përdorin dhe janë të varur nga substancat psikoaktive, gjë që përjashton një numër të konsiderueshëm të dhunuesve nga këshillimi.

Dhuna seksuale konsiderohet një nga format më të rënda të dhunës me bazë gjinore ndaj grave e cila mund të trajtohet vetëm përmes masave legislative dhe masave të tjera jo-rregullatore. Pra, përveç nevojës për miratimin e ndryshimeve të propozuara në Kodin Penal, ekziston nevoja për themelimin e shërbimeve të përshtatshme për mbështetje urgjente dhe afatgjatë të viktimave të dhunës seksuale dhe në të njëjtën kohë shërbime preventive për kryerësit e dhunës seksuale.

Krahas krijimit të programit për dhunuesit si një masë specifike, detyrimi i Maqedonisë së Veriut për të parandaluar dhunën me bazë gjinore duhet të përmbushet përmes masave të tjera të përgjithshme dhe specifike që do të nxisin ndryshime në mentalitetin dhe qëndrimet e njerëzve në përgjithësi.

LPMDhKFDhF përfshin disa masa të përgjithshme preventive që duhet t'i zbatojë çdo institucion dhe organizatë bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Plani për veprim përcakton veprimet konkrete që duhet të zbatojë çdo subjekt në një periudhë të caktuar kohore 2018-2023. Sidoqoftë, pasqyra e Qëllimit 3 në Planin për veprim dhe përgjigjet e dhëna nga ministritë e linjës tregojnë një vonesë në zbatimin e masave parandaluese, posaçërisht për ato aktivitete që synojnë të ndryshojnë zemrat dhe mendjet e njerëzve dhe të transformojnë institucionet për të kuptuar më mirë dimensionin gjinor të dhunës ndaj grave.

Prandaj, Qeveria duhet të marrë në konsideratë një rishikim të menjëhershëm të Planit për veprim dhe të sigurojë një plan më realist me një afat kohor të caktuar dhe burime të përshtatshme financiare për të finalizuar zbatimin e Planit për veprim, i cili është vendimtar për të vendosur themelet për operacionalizimin e plotë të LPMDhKFDhF dhe për një parandalim dhe mbrojtje efektive kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Puna me meshkujt qysh në moshë të hershme duhet të përfshihet në programet e parandalimit dhe mbrojtjes dhe të praktikohet në të gjitha nivelet e ndryshme, duke përfshirë parandalimin e përgjithshëm dhe ndryshimin e sjelljeve përmes planprogrameve zyrtare shkollore, edukimin joformal për djemtë dhe burrat e rinj brenda konteksteve të ndryshme dhe qendrat e këshillimit për djemtë dhe burrat, si dhe punën profesionale me dhunuesit përmes një qasjeje të bazuar në sigurinë e viktimës.